

**MODELE PËR BASHKËPUNIM DHE  
PJESËMARRJE NË NIVEL LOKAL:  
PASQYRË KRAHASUESE**

Ester Hartai  
Katerina Xaxhi-Miceva Evans



# MODELE PËR BASHKËPUNIM DHE PJESËMARRJE NË NIVEL LOKAL: PASQYRË KRAHASUESE

**Botues:**

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

**Për botuesin:**

Aleksandar Kërzhallovski, drejtor i parë ekzekutiv

Dimçe Mitreski, drejtor ekzekutiv

**Autorë:**

Ester Hartai (Eszter Hartay), Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (QEDJ)

Katerina Xaxhi-Miceva Evans, Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (QEDJ)

**Ekipi i projektit:**

Emina Nuredinoska

Marija Sazdevski

**Dizajni:** Broker Inc.

**Shtypi:** Arkus

Mendimet që janë shprehur këtu u takojnë autorëve dhe nuk i reflektojnë qëndrimet e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

Të gjitha të drejtat janë ruajtur. Riprodhimi, kopjimi, transmetimi ose përkthimi i cilëndo pjesë të këtij publikimi mund të bëhet vetëm nën këto kushte: me leje paraprake të botuesit, për shkak të citimit në analizë të librit ose nën kushtet e cekura në vazhdim

Të drejtat e autorit e këtij publikimi janë mbrojtur, por publikimi mund të riprodhohet në cilëndo mënyrë pa pagesë për qëllime edukative. Për kopjimin në kushte tjera, për përdorimin në publikime tjera ose për përkthim ose adaptim, duhet të sigurohet leje paraprake nga botuesi.

Në formë elektronike gjendet në [www.mcms.org.mk](http://www.mcms.org.mk)

*“Ky publikim është përgatitur me ndihmën e bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe në kurrfarë mënyre nuk i reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian.”*



Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian



Projekti është implementuar nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar

# PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	9
2. DOKUMENTE NDËRKOMBËTARE PËR BASHKËPUNIM NË NIVEL LOKAL.....	10
2.1. BASHKIMI EVROPIAN.....	10
2.2. KËSHILLI I EVROPËS.....	10
2.3. DOKUMENTE TË TJERA.....	13
3. RAPORTE PËR VENDIN.....	14
3.1. HUNGARIA.....	14
3.1.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale në Hungari...14	
3.1.2. Dispozitat ligjore.....	14
3.1.2.1. ....	14
3.1.2.2. Прописи на локално ниво.....	15
3.1.3. Instrumentet për bashkëpunim në nivel lokal.....	17
3.1.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale.....	17
3.1.3.2. Trupat për bashkëpunim.....	19
3.1.3.3. Financimi.....	21
3.1.3.4. Model tjetër.....	22
3.2. BOSNJA DHE HERCEGOVINA (BeH).....	23
3.2.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale në Bosnjë dhe Hercegovinë.....	23
3.2.2. Dispozitat ligjore.....	23
3.2.3. Instrumentet për bashkëpunim në nivel lokal.....	24
3.2.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale.....	24
3.2.3.2. Trupat për bashkëpunim.....	25
3.2.3.3. Financimi.....	25

3.3.KROACIA.....	26
3.3.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale në Kroaci...	26
3.3.2. Dispozitat ligjore.....	26
3.3.3. Instrumentet për pjesëmarrje dhe bashkëpunimi në nivel lokal.....	27
3.3.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale.....	28
3.3.3.2. Trupat për bashkëpunim.....	30
3.3.3.3. Financimi.....	31
3.4. REPUBLIKA E SERBISË.....	34
3.4.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale në Serbi...	34
3.4.2. Dispozitat ligjore.....	34
3.4.3. Instrumentet për pjesëmarrje dhe bashkëpunim në nivel lokal.....	35
3.4.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale.....	36
3.4.3.2. Trupat për bashkëpunim.....	36
3.4.3.3. Financimi.....	37
3.5.ANGLIA.....	38
3.5.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale ne Angli.....	38
3.5.2.Dispozitat ligjore.....	38
3.5.3. Instrumentet për pjesëmarrje dhe bashkëpunimi në nivel lokal.....	39
3.5.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale.....	40
3.5.3.2. Trupat për bashkëpunim.....	44
3.5.3.3. Financimi.....	44
4. REZULTATE KRYESORE DHE KONKLUZIONE.....	45
5. REKOMANDIME APO ÇKA TË MERRET PARASYSH KUR BËHET FJALË PËR MODEL PËR BASHKËPUNIM DHE PJESËMARRJE.....	48



# PARATHËNIE

Publikimi “Modele për bashkëpunim dhe pjesëmarrja në nivel lokal: pasqyrë krahasuese” paraqet pasqyrë të kornizës ligjore dhe praktikave të bashkëpunimit të pushteteve lokale me organizatat qytetare në pesë vende evropiane.

Qëllimi i Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) është përmes kësaj analize tu mundësojë të gjitha palëve të interesuara, siç janë organizatat qytetare dhe qytetarët në përgjithësi, vetëqeverisjet lokale dhe të gjitha institucionet në nivel lokal dhe nacional, kuptimi i përmirësuar i pjesëmarrjes qytetare në krijimin e politikave dhe mekanizmave për bashkëpunim mes vetëqeverisjes lokale dhe organizatave qytetare.

Kjo pasqyrë do të kontribuojë dhe drejt vendosjes së mekanizmave për bashkëpunim të komunave në Republikën e Maqedonisë, përmes shqyrtimit të përvojave nga vendet e Bashkimit Evropian (Angli dhe Hungari) dhe vendeve nga rajoni (Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Serbia) të cilat janë paraqitur në publikim.

Analiza u përgatit nga Ester Hartai (Eszter Hartay) dhe Katerina Haxhi-Miceva Evans dhe të dyja nga Qendra Evropiane për të Drejtë Jofitimprurëse (ECNL) nga Budapesti.

MCMS e përgatiti këtë publikim si pjesë nga projekti “Dialogu qytetar në nivel lokal” që është financuar nga EIDHR nga Bashkimi Evropian.

## **Aleksandar Kërzhallovski**

Drejtor i parë ekzekutiv

## **Dimçe Mitreski**

Drejtor ekzekutiv





# 1. HYRJE

---

E drejta e qytetarëve të marrin pjesë në kryerjen e punëve publike është një nga parimet më themelore demokratike dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të realizohet në nivel lokal, atje ku autoritet lokale janë në gjendje që të bashkëpunojnë ngushtë me qytetarët dhe organizatat e tyre dhe të punojnë në probleme të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë mbi jetën e tyre.

Me atë që do ti marrin parasysh mendimet dhe nevojat e qytetarëve dhe do ti inkuadrojnë në punën e vetëqeverisjes lokale, autoritet lokale mund të tërheqin mbështetje për politikat e propozuara. Përmes bashkëpunimit me qytetarët dhe organizatat e tyre gjatë ofrimit të programeve dhe shërbimeve, autoritetet lokale mund të arrijnë deri te resurset, dituritë dhe angazhimet në zbatimin e aktiviteteve të cilat janë me interes të drejtpërdrejtë për bashkësinë. Kjo mund të rezultojë në besimin e ndërsjellë, ndjenjën e pronësisë dhe legjitimitetin më të madh të vendimeve të tyre.

Qëllimi i këtij dokumenti është të prezantohen modelet aktuale të cilat e avancojnë bashkëpunimin dhe inkuadrimin dhe të theksojnë si ato mund të kontribuojnë për partneritetet më të mirë ndër sektorial dhe bashkëpunim efektiv dhe inkuadrin të qytetarëve dhe organizatave qytetare (OQ) në proceset e vendimmarrjeve lokale dhe aktivitetet e vetëqeverisjeve lokale.

Në vetë fillimin, dokumenti jep një pasqyrë të dokumenteve kryesore evropiane për bashkëpunimin OQ-vetëqeverisje lokale, të cilat shërbejnë si një kompas për legjislacionet nacionale. Më tej, dokumenti jep pasqyrë të gjendjes së tanishme të bashkëpunimit në pesë shtete – dy shtete të Bashkimit Evropian (BE) dhe tre shtete nga Ballkani. Si shembuj të dy vendeve të BE, në hulumtimin është prezantuar gjendja e tanishme në Angli dhe Hungari.

Anglia, si demokraci e vjetër, paraqet kampion të praktikave të mira dhe bashkëpunimit mes qeverisë dhe OQ dhe e prezanton realizimin e madh të partneritetit të vërtetë mes vetëqeverisjes lokale dhe OQ – në pikëpamje të asaj se mekanizmat e saja me sukses zbatohen si rezultat i përpjekjeve dhe përkushtimit të gjitha palëve. Hungaria, relativisht anëtare e re e BE, ka sistem të ngjashëm si edhe Maqedonia. Ajo paraqet shembull të statusit që është diçka në mes, ku gjatë 20 viteve të kaluara u miratuan vegla të shumta demokratike, por megjithatë duhet edhe shumë të bëhet që të aplikohen ato në praktikë dhe të bëhen ndryshime në të menduarit. Të tre shtetet nga Ballkani janë Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina (me theks të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës) dhe Serbia. Prej tyre, Kroacia dhe Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës tregojnë përpjekje të rritura të krijohen modele për bashkëpunim dhe të multiplikohen në të gjithë vendin. Serbi tregon tendencë të zhvillohen më shumë mekanizma për bashkëpunim, por ato nuk janë në nivel të njëjtë si edhe dy vendet tjera. Edhe krahas asaj që këto vende mund të ballafaqohen me çështje në pikëpamje të zbatimit të këtyre modeleve, vlen të shqyrtohen disa parametra dhe të merren parasysh në kontekste dhe vende tjera.

Gjatë hulumtimit autorët mbështeten kryesisht në hulumtimin kompjuterik dhe materiale të kapshme në gjuhën angleze dhe gjuhët lokale. Atje ku ishte e mundur, u realizuan intervista me persona zyrtar të cilët udhëheqin me modelet ose me ekspertë të cilët punojnë në vend. Gjithashtu autorët u mbështetën mbi studimet ekzistuese, analizat krahasuese, drejtimet, modelet, informatat dhe këshillat dhe studimet e rastit që të vendosin për modelet të cilat duhet të prezantohen në këtë dokument. Duhet të përmendet se në internet dhe në dokumentet e ndryshme nga hulumtimet që janë bërë në këtë temë ka shumë pak informata për modelet dhe zbatimin e tyre në praktikë. Prandaj, aspekti i zbatimit të gjitha modeleve nuk është hulumtuar në tërësi.

Në këtë analizë bëhen përpjekje që të vendosen modele të tilla të cilat me sukses do të mund të miratohen në praktikë të vetëqeverisjeve lokale. Me qëllim që të sigurohet bashkëpunim efektiv, është e nevojshme të ndërmerren hapa, si në nivel nacional ashtu edhe në atë lokal. Por, shembujt e vendeve tregojnë se edhe krahas asaj që legjislacioni nacional duhet ti vendos rregullat dhe tu jap drejtime vetëqeverisjeve lokale, para së gjithash duhet të respektohet autonomia e autoriteteve lokale dhe aftësisë së tyre të kyçen në partneritete kreative dhe inovative me bashkësitë lokale.

## 2. DOKUMENTE NDËRKOMBËTARE PËR BASHKËPUNIM NË NIVEL LOKAL<sup>1</sup>

### 2.1. BASHKIMI EVROPIAN

Qasja për pjesëmarrje gjatë përgatitjes së politikave dhe ligjeve në nivel të BE dhe shteteve të saja anëtare është inkorporuar në **Marrëveshjen e Lisbonës**<sup>2</sup>. Më konkretisht, neni 10 rregullon se: “Çdo qytetar ka të drejtë të marrë pjesë në jetën demokratike të Unionit. Vendimet miratohen sa është më e mundur në mënyrë më të hapur dhe sa më afër qytetarit”. Kjo gjithashtu është reflektim i obligimeve të autoriteteve lokale të kontribuojnë drejt demokracisë pjesëmarrëse në pajtim me përpjekjet e BE.

Në vitin 2009 Parlamenti Evropian miratoi rezolutë për perspektivat e **Zhvillimi i dialogut qytetar në pajtim me Marrëveshjen e Lisbonës**.<sup>3</sup> Rezoluta është e rëndësishme sepse kjo e forcon rëndësinë e konsultimit dhe i bën thirrje institucioneve të BE që të miratojnë drejtime obliguese për organizimin e konsultimeve dhe rezultateve nga të njëjtat dhe i bën thirrje të udhëheqin regjistër të OQ aktive. Më tej, rezoluta i bën thirrje institucioneve të BE dhe shteteve anëtare tërësisht ti përdorin dispozitat dhe praktikat më të mira që të “të vendosin dialog me qytetarët dhe OQ”, ndërsa veçanërisht në ato regjione dhe sektorë ku nuk janë zhvilluar tërësisht. Rezoluta gjithashtu vërteton se dialogu me qytetarët në të gjitha nivelet kërkon resurse të caktuara financiare, e sipas kësaj i bën thirrje palëve të prekura dhe organeve përgjegjëse të sigurojnë që dialogu i tillë të financohet në mënyrë adekuatë.<sup>4</sup>

Bile edhe para se të miratohet Marrëveshja e Lisbonës, Komisioni Evropian në vitin 2011 e zhvilloi **Librin e bardhë për udhëheqje evropiane**<sup>5</sup>, i cili, mes tjerash, pati për qëllim që ta forcojë kulturën e konsultimit dhe dialogut në nivele të BE dhe në këtë mënyrë ta rrisë legjitimitetin e vendimeve. Libri thekson pesë parime të “udhëheqjes së mirë”: të qenit të hapur, pjesëmarrja, dhënia e llogarisë, efektiviteti dhe konsekuenca, të cilat jo vetëm që “e forcojnë demokracinë dhe sundimin e drejtë në shtetet anëtare, por edhe aplikohen në të gjitha nivelet e qeverisë – globalisht, evropiane, nacionale, rajonale, lokale”.

### 2.2. KËSHILLI I EVROPËS

Këshilli i Evropës zhvilloi dokumente dhe rekomandime të shumta me qëllim që të rritet fuqia dhe pjesëmarrja e qytetarëve në procesin demokratik në nivel lokal, rajonal dhe nacional.

Marrëveshja e parë obliguese ndërkombëtare që i garanton të drejtat e bashkësive dhe autoritet e tyre të zgjedhura dhe e vendosi parimin e subsidiaritetit **Karta Evropiane për vetëqeverisje lokale** që u përgatit në kuadër të Këshillit të Evropës dhe hyri në fuqi më 1 shtator 1998 (në tekstin e mëtejshëm: “Karta Evropiane”). Me nënshkrimin e Kartës Evropiane, shtet u obliguan ta respektojnë thelbin e parimeve kryesore, *inter alia*, e drejta e qytetarëve të marrin pjesë në udhëheqjen me punët publike.

Pjesa 3 në nenin 4 e artikulon parimin e subsidiaritetit siç vijon: “kompetencat publike në përgjithësi realizohen, nëse është e mundur, nga ana e atyre pushteteve të cilat janë më të afër qytetarëve. Dhënia e përgjegjësisë pushtetit tjetër duhet me vëmendje ti marrë parasysh vëllimin dhe natyrën e detyrave dhe kërkesave për efikasitet dhe ekonomizim”.<sup>6</sup>

<sup>1</sup> Pjesa e ardhshme u zhvilluan me ndihmën e Hana Asipoviç (Hanna Asipovich), ECNZ

<sup>2</sup> Version i konsoliduar i Marrëveshjes për Bashkimin Evropian, <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:C:2010:083:0013:0046:EN:PDF>

<sup>3</sup> P6\_TA(2009)0007, 13 janar 2009

<sup>4</sup> Për informata plotësuese, shih: EurActiv.com, “DNJ bëjnë presion për ‘Dialogun e strukturuar të BE’ me qytetarët e BE”, 14 janar 2009, <http://www.euractiv.com/en/socialeurope/meps-push-structured-dialogue-eu-citizens/article-178503>, e pranuar më 14 shtator, 2010

<sup>5</sup> COM(2001) 428

<sup>6</sup> <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/122.htm>

Mundësia për pjesëmarrje të qytetarëve është inkuadruar në konceptin e vetëqeverisjes lokale, që është sqaruar me nenin 3:

“1. Vetëqeverisja lokale e transferon të drejtën dhe aftësinë e pushtetit lokal, në suaza të ligjit, që ta rregullojnë dhe të menaxhojnë me pjesën e madhe të punëve publike, të cilat janë nën përgjegjësinë e tyre, ndërsa në interes të popullatës lokale.

2. Këtë të drejtë do ta realizojnë këshillat ose kuvendet e përbëra nga anëtarë të zgjedhur në mënyrë të lirë me vota të fshehta, në bazë të votimit të drejtpërdrejtë, të barabartë, dhe të përgjithshëm, dhe të cilat mund të kenë organe ekzekutive të cilat do ti japin llogari. Kjo dispozitë në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë që të shkohet kah shoqata të qytetarëve, referendum ose ndonjë formë tjetër e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve atje ku është e lejuar me statut.”

Ministrat evropian përgjegjës për demokraci lokale dhe rajonale në mbledhjen e mbajtur në Konferencën në Valenca, në vitin 2007, e përgatitën **“Deklarata nga Valenca”**, që jep theksin të nevojës që shtetet të miratojnë masa që të sigurohet sjellja etike nga ana e autoriteteve lokale dhe transparencë në udhëheqjen publike dhe vendimmarrje.<sup>7</sup> Mbledhja dha motivim që të zhvillohet një protokoll plotësues drejt Kartës Evropiane për vetëqeverisje lokale dhe formalisht e miratoi Strategjinë për inovacion dhe udhëheqje të mirë, që më vonë në vitin 2008 u miratua nga ana e Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës.<sup>8</sup>

**Protokolli plotësues drejt Kartës Evropiane për vetëqeverisjen lokale për të drejtën e pjesëmarrjes në punët e pushtetit lokal**<sup>9</sup> është rezultat i më shumë se dy dekadave përvojë praktike me punën ndërqeveritare të Këshillit të Evropës lidhur me pjesëmarrjen në nivel lokal. Protokollin e përgatiti Komiteti Evropian për demokraci lokale dhe rajonale (KLRD) dhe është i hapur për nënshkrim nga viti 2009. Protokollin plotësues ka për qëllim në kuadër të Kartës ta inkorporojë të drejtën e çdo individi të marrë pjesë në punët e pushtetit lokal.<sup>10</sup>

Neni 1 nga Protokollin rregullon se:

1. Shtetet anëtare do ta sigurojnë të drejtën e pjesëmarrjes në punën e pushtetit lokal të secilit që është në kompetencën e tyre;

2. E drejta të marrë pjesë në punën e vetëqeverisjes lokale cakton të drejtën të kërkohet të vërtetohet ose të ndikohet në realizimin e autorizimeve dhe përgjegjësi të pushtetit lokal.

Ajo që është e rëndësishme është se në pjesën 3 nga neni 1 vërtetohet përgjegjësia e shtetit nënshkrues të vendos dhe të ketë kornizë ligjore, që e lehtëson të drejtën e pjesëmarrjes në punët e pushtetit lokal.

Më tej, Protokollin rregullon se shtetet duhet të ndërmarrin masa për mbështetje të pjesëmarrjes. Këto masa, siç janë rregulluar në nenin 4 (2), përfshijnë:

„/... tu jepen autorizime pushteteve lokale që tu mundësohet ta avancojnë dhe ta lehtësojnë realizimin e të drejtës së pjesëmarrjes të rregulluar në këtë protokoll;

Il... të sigurohet vendosja e:

*Procedurat për involvimin e njerëzve që mund të përbëhet nga procese konsultative, referendume dhe peticione lokale, e atje ku pushteti lokal ka shumë banorë dhe/ose përfshinë rajon të madh gjeografik, masa që të involvohen njerëz në nivel që është më afër tyre;*

*Procedura për qasje, në pajtim me rregullimin kushtetues dhe obligimet juridike ndërkombëtare të palës, deri te dokumentet zyrtare që i kanë autoritetet lokale;*

c. *Masa për plotësimin nevojave të kategorive të njerëzve të cilët ballafaqohen me pengesa të caktuara gjatë pjesëmarrjes; dhe*

ç. *Mekanizma dhe procedura për zgjidhjen e veprimeve dhe sugjerimeve lidhur me funksionimin e*

<sup>7</sup> Ministrat e Këshillit të Evropës promovojnë udhëheqje të mirë demokratike në nivel lokal: [www.eukn.org/E\\_library/Urban\\_Policy/Council\\_of\\_Europe\\_ministers\\_promote\\_good\\_democratic\\_governance\\_at\\_local\\_level](http://www.eukn.org/E_library/Urban_Policy/Council_of_Europe_ministers_promote_good_democratic_governance_at_local_level)

<sup>8</sup> Strategjia për inovacion dhe udhëheqje të mirë (2008):

[www.coe.int/t/dgap/localdemocracy/Strategy\\_Innovation/Strategy\\_Brochure\\_E.pdf](http://www.coe.int/t/dgap/localdemocracy/Strategy_Innovation/Strategy_Brochure_E.pdf)

<sup>9</sup> <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/207.htm>

<sup>10</sup> Lexoni komentin ndaj Protokollit: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Reports/Html/207.htm>

*pushtetit lokal dhe shërbimeve publike lokale;*

*III... nxitja që të shfrytëzohen informata dhe teknologji komunikuese për avancimin e të drejtës së pjesëmarrjes të caktuar në këtë protokoll.“*

Protokolli pranon se procedurat, masat dhe mekanizmat mund të jenë të ndryshëm për kategori të ndryshme të pushteteve lokale, duke marrë parasysh madhësinë dhe kompetencat e ndryshme. Ai gjithashtu e thekson rëndësinë e konsultimit me autoritetet lokale të cilat zhvillojnë mekanizma të këtilla në nivel nacional.

Njohja e rëndësisë së dialogut me qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur lokal dhe faktin se suksesi i cilësdo politikë për pjesëmarrje demokratike lokale varet nga përpjekja e autoriteteve lokale, në vitin 2001 **Komiteti i ministrave të Këshillit të Evropës e miratoi Rekomandimin 19** deri te shtetet anëtare për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike lokale (në tekstin e mëtejshëm: “*Rekomandimi*”),<sup>11</sup>

Komiteti i ministrave u rekomandon qeverive të shteteve anëtare:

1. të vendosin politika duke i përfshirë edhe ato lokale, dhe ku mund të aplikohet, autoritetet rajonale të dizjenuara ta avancojnë pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën politike lokale, e cila do të bazohet mbi parimet e Kartës Evropiane, si dhe mbi parimet e përmbajtura në Rekomandim;
2. të miratojnë masa në kuadër të autorizimeve të tyre, veçanërisht me qëllim që të përmirësohet korniza ligjore për pjesëmarrje dhe të sigurohet legjislacion nacional dhe rregulloret tu mundësojë autoritete lokale dhe rajonale të përfshijnë numër të madh të instrumenteve për pjesëmarrje;
3. ti ftojnë, në mënyrë adekuate, autoritete lokale dhe rajonale:
  - të angazhohen për parimet e rekomandimit dhe të ndërmarrin zbatim efektiv të politikave për avancimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike lokale;
  - ti përmirësojnë rregulloret lokale dhe organizimet praktike lidhur me pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike lokale dhe të ndërmarrin masa të tjera në kuadër të autorizimeve të tyre, që të avancohet pjesëmarrja e qytetarëve, duke i respektuar tërësisht masat e cekura në Protokoll;
4. të sigurojnë që Protokollin të përkthehet në gjuhën ose gjuhët zyrtare të vendve të tyre adekuate, dhe në mënyrë të cilën ata e llogarisin si adekuate dhe për atë të informohen autoritetet lokale dhe rajonale.

Komiteti i ministrave i theksoi 13 parimet themelore që vijojnë të politikës për pjesëmarrje demokratike lokale:

- ✓ garanci e të drejtës së qytetarëve të kenë qasje deri te informata të qarta, gjithëpërfshirëse;
- ✓ kërkesë të mënyrave të reja që të përmirësohet interesimi aktiv qytetar për nevojat e bashkësisë;
- ✓ zhvillimi i vetëdijes së përkatësisë ndaj një bashkësie;
- ✓ inkurajimi i liderëve lokalë që të japin theks për pjesëmarrje të qytetarëve;
- ✓ miratimi i qasjes gjithëpërfshirëse për çështjet e pjesëmarrjes së qytetarëve;
- ✓ sigurimi i një spektri të gjerë të instrumenteve për pjesëmarrje;
  - fillimi një vlerësimi të thellë të gjendjes dhe vendosja e sistemit për vëzhgim;
  - sigurimi i shkëmbimit të informatave dhe të mësuarit e përbashkët për efektivitetin e metodave të ndryshme për pjesëmarrje;
- ✓ ti kushtohet vëmendje e veçantë atyre të cilët mbeten jashtë jetës publike lokale;
- ✓ pranimi i rëndësisë nga përfaqësimi i drejtë i gruas në politikat lokale;
- ✓ theksimi i rolit të fëmijëve dhe të rinjve;
- ✓ pranimi dhe avancimi i rolit që e kanë shoqatat dhe grupet e njerëzve; dhe
- ✓ sigurimi i mbështetjes për përpjekje të përbashkët të autoriteteve në çdo nivel territorial.

<sup>11</sup> <https://wcd.coe.int/wcd/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=871861&SecMode=1&DocId=1268766&Usage=2>

Në dritën e parimeve të sipërme, Rekomandimi cakton hapa dhe masa konkrete për nxitjen dhe forcimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike lokale.

**Rekomandimet e Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës deri te shtetet anëtare për statusin juridik të OQ nga viti 2007** rregullojnë se “Mekanizmat qeveritare dhe huazi qeveritare në të gjitha nivelet duhet të sigurojnë pjesëmarrje efektive të OQ në dialogun dhe konsultimin për qëllimet dhe vendimet për politikën publike, pa kurrfarë diskriminimi. Pjesëmarrja e këtyllë të sigurojë shprehjen e lirë të mendimeve të personave të ndryshëm në pikëpamje të funksionimit të shoqërisë. Kjo pjesëmarrje dhe bashkëpunim duhet të lehtësohen me atë që do të sigurohet dhënia ose qasja adekuate deri te informatat zyrtare. OQ duhet të konsultohen gjatë përgatitjes së propozim legjislativ primar dhe sekondar, që ndikon mbi statusin e tyre, financimin ose fushën e punës”.<sup>12</sup>

**Strategjia për inovacion dhe udhëheqje të mirë në nivel lokal** ishte përgatitur si instrument praktik që të jenë sinergji mes të gjitha palëve të prekura dhe të sigurojnë përmirësimin e udhëheqjes lokale. Strategjia bazohet mbi 12 parime, të cilat përfshijnë një definicion gjithëpërfshirës për udhëheqje demokratike me kualitet të mirë dhe mund të shërbejë si përcaktues për punën e pushtetit lokal. Parimi i parë ka të bëjë me zbatimin e drejt të zgjedhjeve, avokim dhe pjesëmarrje. Mes tjerash, këtu thuhet se: “Të gjithë meshkujt dhe femrat të kenë të drejtë vote në vendimmarrje, qoftë drejtpërdrejt ose përmes trupave ndërmjetësues legjitim, të cilët i përfaqësojnë interesat e tyre. Pjesëmarrja e këtyllë e gjerë bazohet mbi lirinë e shprehjes, grumbullimit dhe shoqërimin”.

Strategjia vendos një mekanizëm për zbatim, i cili bazohet në katër shtylla:

- ✓ Angazhimi i autoriteteve individuale lokale që ta përmirësojnë punën e tyre në pikëpamje të 12 parimeve;
- ✓ Programe aksionare nacionale;
- ✓ Përshkrimi i udhëheqjes së mirë demokratike<sup>13</sup>; dhe
- ✓ Platformë e të gjitha palëve të prekura.

Strategjia në mënyrë plotësuese u mbështet me dokumentin për zbatim “**Drejt implementimit**”<sup>14</sup> që i zhvillon shtyllat e sipërme.

Edhe krahas asaj që nuk ka karakter ligjor, gjithashtu vlen të përmendet edhe **Kodeksi për praktikë të mirë për pjesëmarrje qytetare në procesin e vendimmarrjes**, i cili u miratua në konferencën e MGO më 1 tetor 2009 (në tekstin e mëtejshëm “Kodeksi për praktikë të mirë”).<sup>15</sup> Kodeksi i praktikës së mirë rregullon një përmbledhje të parimeve të përgjithshme, drejtimeve, veglave dhe mekanizmave për pjesëmarrje qytetare në mekanizmin për vendimmarrje politike me qëllim që të zbatohet në nivel lokal, rajonal dhe nacional.

## 2.3. DOKUMENTE TË TJERA

Ekzistojnë konventa të tjera të shumta ndërkombëtare, të cilat e theksojnë rëndësinë e qasjes deri te informatat dhe pjesëmarrjes publike në proceset e vendimmarrjeve. Komisioni ekonomik për Evropë i Kombeve të Bashkuara, më 25 qershor 1998, e miratoi **Konventën për qasje deri te informatat, pjesëmarrjen publike në vendimmarrje dhe qasja deri te drejtësia për çështje nga mjedisi jetësor**, në qytetin danez Arhus, në Konventën e katërt të ministrave për procesin e “Mjedisit jetësor për Evropë” (në tekstin e mëtejshëm: “Konventa nga Arhusi”).<sup>16</sup> Konventa nuk është vetëm marrëveshje për mjedisin jetësor, por gjithashtu edhe konventë lidhur me dhënien e llogarisë së qeverisë, transparencës dhe përgjegjësisë. Konventa e Arhusit i jep të drejtat publike dhe ua imponon si autoriteteve të huaja, ashtu edhe publike, obligime lidhur me qasjen deri te informatat dhe pjesëmarrjen publike dhe qasje deri te

<sup>12</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2007) 14 nga Komiteti i ministrave deri te shtetet anëtare për statusin juridik të organizatave joqeveritare në Evropë.

<sup>13</sup> Përshkrimi evropian i udhëheqjes së mirë:

[http://www.coe.int/t/dgap/localdemocracy/Strategy\\_Innovation/ELoGE\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dgap/localdemocracy/Strategy_Innovation/ELoGE_en.asp)

<sup>14</sup> Стратегија за иновација и добро управување на локално ниво – кон спроведување:  
<https://wcd.coe.int/wcd/com.instranet.InstraServlet?command=com.instranet.CmdBlobGet&InstranetImage=1766578&SecMode=1&DocId=1696278&Usage=2>

<sup>15</sup> Teksti i Kodeksit për praktikë të mirë mund të gjendet në internet faqen që vijon:  
[http://www.coe.int/t/ngo/Source/Code\\_English\\_final.pdf](http://www.coe.int/t/ngo/Source/Code_English_final.pdf)

<sup>16</sup> Teksti i Kodeksit për praktikë të mirë mund të gjendet në internet faqen që vijon:  
<http://www.unece.org/env/pp/documents/cep43e.pdf>

drejtësia.<sup>17</sup> Konventa e Arhusit nuk bën dallime mes niveleve qeveritare, nga shtetet kërkohet gjithashtu ti zbatojë rregulloret për autoritetet publike në nivel nacional, rajonal dhe lokal.<sup>18</sup>

## 3. RAPORTE PËR VENDIN

Pjesa që vijon jep pasqyrë për gjendjen në vendet të cilat u hulumtuan për qëllimet e këtij dokumenti. Çdo vend është prezantuar nga pikëpamja e kornizës ligjore për bashkëpunim dhe pjesëmarrje dhe modelet më të përgjithshme, që përdoren për avancimin e partneritetit dhe inkuadrimit të tillë.

### 3.1. HUNGARIA

#### 3.1.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale në Hungari

Decentralizimi i pushtetit të vetëqeverisjeve lokale ndodhi në vitet e hershme të 1990. Ligji për vetëqeverisje lokale u miratua në vitin 1990.<sup>19</sup>

Pushteti lokal ekziston në dy nivele: komunal dhe i rrethit. Komunat janë njësi themelore të sistemit dhe janë organizuar në vendbanime, duke përfshirë fshatrat, qytetet dhe qytetet me të drejtë të rrethit. Shtresa e mesme e pushtetit lokal përbëhet prej dymbëdhjetë rretheve. Budapesti, si kryeqytet i Hungarisë, ka status të veçantë juridik.

Nuk ekzistojnë raporte hierarkike mes komunave dhe rretheve. Sipas Kushtetutës<sup>20</sup>, të drejtat themelore të gjitha vetëqeverisjeve lokale janë të barabarta. Qeveritë në nivel të rretheve nuk janë superiore dhe nuk kanë pushtet mbikëqyrës mbi komunat. Dallimi mes këtyre dyjave shtrihet në detyrat udhëheqëse të deleguara te secila prej tyre: rrethet sigurojnë shërbime publike, ku vendbanimet nuk janë në gjendje ti kryejnë.<sup>21</sup>

#### 3.1.2. Dispozitat ligjore

##### 3.1.2.1. Dispozita në nivel nacional

**Kushtetuta** që është në fuqi e rregullon kërkesën për bashkëpunim me OQ të interesuara, por kjo ka të bëjë vetëm me qeverinë. Për fat të keq, para do kohe kushtetuta e miratuar e quajtur “Ligji themelor”, që hyri në fuqi më 1 janar 2012, bile edhe nuk përfshinë obligim të këtillë.

**Ligji për pjesëmarrje sociale në përgatitje të dispozitave ligjore**<sup>22</sup> i miratuar para do kohe nuk aplikohet për vetëqeverisjet lokale, ai vetëm i rregullon rregullat për pjesëmarrje në nivel nacional. Sipas argumentit të Ligjit, shkak për përjashtimin e rregullave për pushtetet lokale nga përfshirja e Ligjit pjesërisht është për shkak se në të gjitha fshatrat nuk ka në dispozicion kushte teknike për konsultim të përgjithshëm. Para së gjithash, shkak është se elementi kryesor për autonomi të pushtetit lokal është formulimi i pavarur i dispozitave lokale, të cilat nuk është dashur të jepen aq në hollësi me ligjin nacional. Nga ky shkak, këshillat komunale janë në gjendje ti caktojnë rregullat e pjesëmarrjes sociale në përgatitjen e dekreteve të vetëqeverisjes lokale në bazë të rrethanave dhe veçorive të tyre lokale.

<sup>17</sup> <http://www.unece.org/env/pp/welcome.html>

<sup>18</sup> Burime plotësuese: Demokracia lokale dhe rajonale – internet faqja e CoE: [http://www.coe.int/t/dgap/lo-caldemocracy/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dgap/lo-caldemocracy/default_en.asp)

Informata dhe këshilla të CoE për programet për ndërtimin e kapaciteteve të pushtetit lokal, pjesa për pjesëmarrje të bashkësisë: [http://www.coe.int/t/dgap/localdemocracy/Centre\\_Expertise/Tools/ToolkitI.pdf](http://www.coe.int/t/dgap/localdemocracy/Centre_Expertise/Tools/ToolkitI.pdf) OECD, Vlerësimi i pjesëmarrjes publike në krijimin e politikës (2005):

[http://www.oecd.org/document/2/0,3746,en\\_2649\\_34135\\_40758338\\_1\\_1\\_1\\_1,00.html](http://www.oecd.org/document/2/0,3746,en_2649_34135_40758338_1_1_1_1,00.html)

<sup>19</sup> Akti nr. LXV nga 1990 për qeveritë lokale

<sup>20</sup> Pjesa 43 nga akti XX nga viti 1949

<sup>21</sup> [http://lgi.osi.hu/country\\_datasheet.php](http://lgi.osi.hu/country_datasheet.php)

<sup>22</sup> Akti CXXXI nga viti 2010, hyri në fuqi më 1 janar 2011

Sipas Ligjit dhe arsyetimit të dhënë këtu, **Ligji për vetëqeverisjet lokale**<sup>23</sup> do të plotësohet nga 1 korriku i vitit 2011, që të përfshijë një dispozitë, që pushteti lokal të und ti rregullojë rregullat për pjesëmarrje sociale në përgatitje të rregullave lokale në formë të dekreteve. Më saktë, sipas amendamentit, Ligji për vetëqeverisjet lokale (pjesa 18) do ti përfshijë dispozitat që vijojnë, të cilat kanë të bëjnë me pjesëmarrjen qytetare: *“Këshilli komunal do të vërtetojë rregulla të hollësishtme për punën e tij në dekretin për rregullat organizative dhe operative. Këshilli komunal do ta vërtetojë renditjen e formave të këtylla (forume politike fshatare dhe qytetare, konsultim e një pjese të qytetit, mbledhje në fshat etj.) të cilat shërbejnë për informim të drejtpërdrejtë të njerëzve, organizatave joqeveritare dhe inkuadrimin e tyre në përgatitjen e vendimeve më adekuate. Këshilli komunal do të informohet për qëndrimin e tyre dhe mendimet e dhëna të pakicave”.*

Gjithashtu, **Ligji për legjislacion**<sup>24</sup>, i miratuar me Ligjin për pjesëmarrje shoqërore, nuk përfshinë dispozita të cilat kanë të bëjnë me pjesëmarrjen qytetare në nivel lokal. Edhe krahas asaj se ai ka pjesë të veçantë (numri 19), që ka të bëjë me rregullat që të bëhet konsultim sipas propozim dispozitave ligjore, ai e përfshinë: *“Derisa një akt në mënyrë të qartë e siguron të drejtën që shteti, pushteti lokal ose ndonjë organizatë tjetër të jep mendim për propozim dispozitat ligjore të cilat ndikojnë mbi statusin e tyre juridik ose përfshirje të aktivitetit, përgatitësi i dispozitës ligjore do të kujdeset për atë që organi në fjalë ti realizojë të drejtat e tija.”*

E drejta për informim të saktë dhe në kohë të opinionit është inkorporuar në **Ligjin për liri të informatave elektronike**.<sup>25</sup> Nga vetëqeverisjet lokale kërkohet të shpallen të dhënat organizative ose personale dhe të dhënat lidhur me aktivitetet e tyre, punën dhe udhëheqjen (të dhënat e nevojshme janë cekur në aneksin e Ligjit) në internet faqen tyre ose në mu ngesë të internet faqes së tyre, në internet faqen qendrore.

Në përgjithësi, pjesëmarrja qytetare në nivel lokal është e rregulluar dobët me legjislacionin nacional.

### 3.1.2.2. Dispozita në nivel lokal

Si një shembull i mirë për rregullimin e pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal, Këshilli i qytetit të Budapestit miratoi në veçanti **Dekret për çështjet e raportit mes OQ dhe Komunës Budapest dhe Procedura për vendosjen e tenderëve**.<sup>26</sup>

Dekreti e siguron të drejtën e OQ ta shtrojnë mendimin e tyre dhe i rregullon rregullat për pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes. Disa nga format konkrete për bashkëpunim të përfshira në Dekret janë: I) organizatat qytetare janë të ftuara në mbledhjet e Këshillit të Qytetit; II) OQ mund të japin komente për ato propozime të cilat i prekin qytetarët dhe përfshijnë çështje konceptuale; III) formimi i trupave konsultative për çështje konkrete ku janë inkuadruar OQ; IV) mbajtja e forumeve qytetare për shkak të informimit dhe konsultimit; V) formimi i këshillit këshillëdhënës dhe pajtimit.

Një nga modelet që u vendosën me aneksin 1 të Dekretit ishin këshillat konsultative, ose të ashtuquajturit **këshilla konsultative ose punëtori qytetare**, model i bashkëpunimit dhe partneritetit, që ngadalë miratohet në bashkësitë tjera.

<sup>23</sup> Akti LXV nga viti 1990

<sup>24</sup> Akti CXXX nga viti 2010

<sup>25</sup> Akti HS nga viti 2005

<sup>26</sup> 61/2008. (XI.21.) Local government decree. Teksti hungarez mund të gjendet në internet lidhjen që vijon: [http://www.budapest.hu/engine.aspx?page=civil\\_deklaracio](http://www.budapest.hu/engine.aspx?page=civil_deklaracio)



## **Rregulla kornizë për punën e këshillave konsultative (të ashtuquajtura punëtori qytetare) të cekura në Aneksin 1 nga Dekreti**

### **► Qëllimet e punës së trupave qytetare**

1) Këshilli këshillëdhënës qytetar dhe punëtoritë sektoriale-profesionale qytetare (në tekstin e mëtejshëm: trupa qytetare) paraqesin forumë institucionale për lidhje mes komunës dhe sektorit të vetorganizuar publik në Budapest, në bazë të parimeve demokratike të pjesëmarrjes, partneritetit dhe opinionit qytetar.

2) Trupat qytetare sigurojnë kornizë të organizuar për pjesëmarrje të bashkësive dhe qytetarëve në punët publike dhe shqyrtimin e mendimit të tyre në vendimet e Komunës së Budapestit.

### **► Procedura për vendosjen e sistemit të trupit qytetar**

3) Me vendosjen e sistemit të trupit qytetar, Zyra e prefektit shpall iniciativë deri te bashkësitë e vetorganizuar të Budapestit dhe formular për paraqitje, me qëllim që të formohen punëtori profesionale qytetare, të cilat merren me çështje me personat e rritur, personat me pengesa në zhvillim, drogë, të pastrehë, çështje sociale, mbrojtje shëndetësore, mbrojtja e ambientit jetësor, zhvillimi i qytetit, puna në qytet, arsimimi, kultura dhe sporti.

4) Organizatat qytetare e shtrojnë kërkesën e tyre në kuadër të afatit të caktuar, me atë që do ta caktojnë punëtorinë profesionale në të cilën dëshirojnë të marrin pjesë, pastaj personi konkret do ta prezantojë organizatën në bazë të vendimit të këshillit të saj.

5) Në bazë të kërkesave të parashtruara, zyra e prefektit zbaton procedurë për akreditim sipas kësaj që vijon:

- Organizata qytetare kërkuese të jetë e regjistruar nga ana e gjykatës dhe të jetë subjekt juridik;

- Forma ligjore e organizatës qytetare të jetë shoqatë (lidhje) ose fondacion;

- Organizata qytetare të punojë kryesisht në Budapest për shkak të interesit të njerëzve nga kryeqyteti;

- Ato organizata qytetare të cilat janë formuar të mbështesin aktivitetin dhe punën e institucioneve të pushtetit lokal, mund të bëhen anëtare të sistemit vetëm në rast kur u jep shërbime banorëve, përveç se i mbështesin institucionet.

6) Kërkuësve di tu jepet mundësia që të parashtrojnë dokumente të cilat mungojnë gjatë procedurës për akreditim. Kërkesa do të refuzohet në rast se kërkuesi të mos i korrigjojë mungesat gjatë afatit të caktuar. Por, kjo nuk e përjashton mundësinë që përsëri të kërkojë – me atë që do ti plotësojë kërkesat për akreditim më vonë. Kërkesa për punëtoritë është vazhdueshme dhe e hapur.

7) Punëtoritë e dhënë profesionale mund të vendoset nëse për këtë paraqiten për pjesëmarrje në punën e saj më së paku 5 organizata. Punëtoritë profesionale do të pushojnë në rast se numri i organizatave të cilat de facto marrin pjesë në punën e saj është më pak se 5.

8) Mbledhja e parë e punëtorisë profesionale e cakton Zyra e kryetarit të komunës. Ajo e informon komitetin, i cili ka kompetencë profesionale rreth çështjeve të caktuara për formimin e punëtorisë. Zyra e kryetarit të komunës e shpall listën e atyre organizatave qytetare të cilat kanë të drejtë të marrin pjesë në punëtorinë profesionale.

9) Në mbledhjen e saj të parë punëtoritë profesionale vendosin rregullat e veta operative në pajtim me dispozitat nga dekreti dhe e zgjedhin kryetarin nga anëtarët e tyre me mandat prej një viti.

10) Kryetarët e punëtorive profesionale e përbëjnë Këshillin për konsultim qytetar. Mbledhjen e parë të Këshillit e thërret Zyra e kryetarit të komunës. Në mbledhjen e parë të vet, Këshilli vendos rregullat e veta operative në pajtim me dispozitat nga Dekreti dhe e zgjedh kryetarin nga anëtarët e vet me mandat prej një viti. Ko-kryetari i Këshillit është personi i cili caktohet nga ana e Kuvendit gjeneral të kryeqytetit dhe është përgjegjës për marrëdhënie qytetare.

11) Pasi të zhvillohet sistemi për trup qytetar, Këshilli për konsultim qytetar vendos të themlojë punëtori plotësuese profesionale ose të pushojë ose ti bashkojë ato ekzistueset. Para se ta sjell vendimin e vet, Këshilli për konsultim civil negocion me komitetet e Kuvendit gjeneral.



### ► E drejta dhe kompetenca e trupave qytetare

12) Punëtoritë sektoriale-profesionale mund ta japin mendimin e vet lidhur me dokumentet për të cilat kërkohet mendim që i ka siguruar Kuvendi gjeneral dhe komitetet e Kuvendit gjeneral.

13) Këshilli për konsultim qytetar e jep mendimin e vet lidhur me çështjen konceptuale për raportet vetëqeverisje lokale – qytetarë dhe çështje të tjera të cilat nuk janë specialitet i cilësdo punëtori.

14) Punëtoritë sektoriale-profesionale mund të japin sugjerime nga komiteti i caktuar i Kuvendit gjeneral dhe Këshilli për konsultim qytetar deri te Kuvendi gjeneral që të diskutojë për çështje dhe propozime konkrete.

15) Sistemi i trupit qytetar – në bazë të bashkëpunimit me çdo komitet, i përmbledh përvojat lidhur me statusin, punën, mundësitë për zhvillim të partneritetit mes qytetarëve – pushteti lokal çdo vit, më tej përgatit vlerësim të shkurtër për Kuvendin gjeneral të kryeqytetit, që dorëzohet nga ana e personit të caktuar nga Kuvendi gjeneral i kryeqytetit dhe përgjegjës për marrëdhënie qytetare.

Por, në disa komuna nuk ekziston dekret i veçantë me të cilin rregullohen pjesëmarrja qytetare dhe ata në vend të kësaj, janë orientuar drejt praktikës.<sup>27</sup> Me siguri kjo situatë do të ndërrojë menjëherë pasi të hynë në fuqi dispozitat e reja nga Ligji për vetëqeverisjet lokale.

### 3.1.3. Instrumentet për bashkëpunim në nivel lokal

Ekzistojnë lloje të ndryshme të instrumenteve që përdoren në Hungari, për tu avancuar bashkëpunimi ndër sektorial në nivel lokal. Në vitin 2003 Qeveria e miratoi Strategjinë qytetare për bashkëpunim dhe në bazë të Strategjisë, disa vetëqeverisje lokale e miratuan dokumentin e tyre politik, duke i inkuadruar në mënyrë të barabartë vërejtjet e përgjithshme dhe veçoritë lokale. Çështjet të cilat kanë të bëjnë me shoqërinë civile shpesh herë i delegohen personit zyrtar, që zakonisht punon në departamentin për kulturë të komunës, por për shkak të kapacitetit të kufizuar, kjo zakonisht është në kombinim me obligimet tjera (siç janë çështjet rinore). Komuna e Budapestit është shembulli i vetëm ku funksionon zyra qytetare. OQ mund ta japin mendimin e tyre në këshilla qytetare ose në punëtoritë tematike qytetare – siç është cekur më sipër në rastin me Budapestin, që punon me mbështetje administruese dhe infrastrukturore, që e siguron vetëqeverisja lokale. Vetëqeverisjet lokale gjithashtu i mbështesin organizatat e shoqërisë civile përmes llojeve të ndryshme të mjeteve të pakthyeshme, por ekziston dallim i madh mes mjeteve që i distribuon çdo njëra nga vetëqeverisjet lokale.

#### 3.1.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale

##### Dokumentet politike në nivel shtetëror

**Strategjia qytetare e qeverisë hungareze** u miratua në vitin 2003 edhe krahas asaj që përfshinë deklaratatë të përgjithshme për statusin e sektorit civil është e orientuar drejt përpjekjeve qeveritare që të avancohet puna efektive e organizatave qytetare, ajo gjithashtu ka disa propozime për nevojën nga pjesëmarrja qytetare në nivel lokal. Si për shembull, Strategjia thotë se punës së OQ i ndihmon politika qeveritare sipas të cilës kontrolli qytetar i qeverisë dhe pushtetit lokal, ndarja e punës mes qeverisë/pushtetit lokal, sektorit afarist dhe organizatave të shoqërisë civile dhe bashkëpunimi i tyre janë të domosdoshme.

Në Strategjinë qytetare, qeveria thekson se ata presin që të gjitha institucionet e drejtorisë të identifikohen me parimet e kyçura në Strategji, e gjithashtu jep shembull i cili duhet të ndiqet nga ana e vetëqeverisjeve lokale.

<sup>27</sup> Siç përmendi një nga personat zyrtar për çështje qytetare: “Ne ose vëmë çdo gjë në letër ose e vazhdojmë kohën që ta materializojmë bashkëpunimin në praktikë”.

Në pajtim me këtë intervenim, disa vetëqeverisje lokale miratuan strategji të tyre qytetare në 8 vitet e kaluara, e veçanërisht mes viteve 2003 dhe 2005<sup>28</sup>. Bile dehe gjatë vitit të kaluar vetëqeverisjet lokale miratuan strategji të reja qytetare.<sup>29</sup> Katër vjet më vonë qeveria e mëparshme e miratoi **Rezolutën për masat të cilat shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve qeveri-sektori civil**<sup>30</sup> me qëllim që në mënyrë plotësuese ta nxisin bashkëpunimin mes qeverisë dhe OQ.

Në bazë të rezolutës obliguese juridike, çdo ministri<sup>31</sup> përgatit planin e vet aksionar. Në të kundërtën nga Strategjia, Rezoluta vendosi qasje të re të decentralizmit të implementimit dhe avancimit të bashkëpunimit mes ministrive dhe OQ. Prej tyre është e rëndësishme të përmendet Plani aksionar qytetar i ish Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale dhe Zhvillim Rajonal që e përgatit bashkëpunimin lokal.

Plani qytetar aksionar i ish Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale dhe Zhvillim Rajonal (2007-2008) i vërteton detyrat që vijnë të cilat e tejkalojnë nivelin nacional dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë mbi bashkëpunimin OQ – vetëqeverisje lokale:

- ✓ Sistemi për bashkëpunim në dialogun social do të vendoset në nivel rajonal;
- ✓ Informatat dhe këshillat profesionale, duke i përfshirë edhe praktikantët e mira në Hungari dhe në shtetet anëtare të BE, do të përgatiten për vetëqeverisje lokale dhe partneritetet e tyre me qëllim që të avancohet dorëzimi i kompetencave me interes publik nga ana e vetëqeverisjes lokale në sektorin civil;
- ✓ Aleancat dhe OQ reprezentues do të inkuadrohen në përgatitjen e propozim ligjesh të tilla (organizata, puna e vetëqeverisjeve lokale, mbikëqyrja e kompetencave, financimi etj.) të cilat mund ta lehtësojnë zgjerimin e marrëdhënieve OQ – vetëqeverisje lokale;
- ✓ Për inkuadrimin e OQ në punën e shtetit dhe kompetencat e vetëqeverisje lokale do të përgatisin rekomandime;
- ✓ Gjatë komunikimit me komunat ato do të inkurajohen të përfshijnë OQ në kryerjen e obligimeve të vetëqeverisjes lokale;
- ✓ Gjatë komunikimit me komunat do të inkurajohen metoda të ndryshme për bashkëpunim, ndërsa ato ekzistuese do të avancohen.<sup>32</sup>

## Dokumente politike në nivel lokal

Strategjitë e hulumtuara qytetare përfshijnë argumentim për qëllimin e tyre personal dhe shkakët për miratimin e tyre, rëndësinë dhe gjendjen lokale në sektorin civil, listë dhe hyrje e shkurtë e OQ lokale, qëllimet strategjike dhe konkrete, kanalet për komunikim, rregullat për inkuadrin të OQ në procedurën për vendimmarrje, format për mbështetje dhe rregullat për financim.

Struktura e **Strategjisë qytetare e Vishegradit** e miratuar në vitin 2010 në mënyrë të bukur i prezanton temat të cilat duhet të rregullohen në një dokument për politikë lokale.

<sup>28</sup> Për shembull, *Strategjia qytetare e Zentes* (janar 2005), *Strategjia qytetare e Zolnok* (nëntor 2003), *Koncepti qytetar i Niregihaza* (janar 2004).

<sup>29</sup> Për shembull, *Strategjia qytetare nga rrethi XV i Budapestit* (mars 2009), *Strategjia qytetare e Vishegradit* (prill 2010), *Strategjia qytetare e Debrecenit* (nëntor 2010).

<sup>30</sup> 1065/2007. (VIII.23.) Governmental Resolution

<sup>31</sup> Për shembull:

Ministria për Marrëdhënie Sociale dhe të Punës: <http://www.szmm.gov.hu/main.php?folderID=16437&articleID=32285&ctag=articlelist&iid=1>

Ministria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural:

<http://www.vmm.gov.hu/main.php?folderID=2044&articleID=13722&ctag=articlelist&iid=1>

<sup>32</sup> I gjithë teksti i planit aksionar mund të gjendet në internet faqen që vijon:

[http://www.otm.gov.hu/web/bmtvtev.nsf/0/4D94EABBE4FA4881C12575E4004596A5/\\$FILE/7\\_2008\\_OTM-ut.pdf?OpenElement](http://www.otm.gov.hu/web/bmtvtev.nsf/0/4D94EABBE4FA4881C12575E4004596A5/$FILE/7_2008_OTM-ut.pdf?OpenElement)

- ✓ Hyrje
- ✓ Vlerësimi i gjendjes së tanishme
- ✓ Kategorizimi i OQ të cilat punojnë në Vishegrad
- ✓ Roli dhe rëndësia e OQ
- ✓ Vendosja e bashkëpunimit mes vetëqeverisjes lokale dhe OQ
- ✓ Qëllimet e përbashkëta të vetëqeverisjes lokale dhe sektorit civil
- ✓ Qëllimet e përgjithshme
- ✓ Qëllimet konkrete
- ✓ Informata dhe këshilla për implementim
- ✓ Monitorimi i implementimit
- ✓ Pasqyrë e shkurtër

Gjithashtu, vlen të citohet Zentes si shembull i mirë duke marrë parasysh atë se **strategjia civile e miratuar nga ana e këshillit komunal të Zentes** është orientuar drejt veçorive lokale (inkuadron një pasqyrë të përgjithshme të Zentes), krahas asaj që e thekson rëndësinë e OQ dhe bashkëpunimit të tyre me vetëqeverisjen lokale. Në bazë të strategjisë qytetare, **këshilli qytetar i komunës Zentes** ishte formuar nga ana e OQ, që llogaritej si partner i vetëqeverisjes lokale dhe i përfaqëson interesat e OQ. Komuna e korrigjon strategjinë qytetare një herë në dy vjet dhe në plan të veçantë aksionar inkudrohen politika të reja strategjike për dy vitet e ardhshme.

Në bazë të planit të këtillë aksionar, pushteti i tanishëm lokal përpiket të vendos të ashtuquajturin **“Dhoma qytetare”**.<sup>33</sup> Ideja qëndron aty se Dhoma qytetare do të shërbejë për funksionet e ardhshme: I) do të ndihmojë në bashkëpunimin mes organizatave qytetare dhe vetëqeverisjet rajonale, qytetare dhe të pakicave dhe pjesëmarrja e OQ në vendimmarrje përmes forumeve të rregullta koordinuese, tryezave të rrumbullakëta; II) rregullisht do të kontaktojë me organizata të shumta qytetare formale dhe iniciativa lokale joformale personalisht dhe me anë të postës elektronike; III) do të sigurojë aktivitete për zhvillim të bashkësisë; IV) do të organizojë trajnime rreth këtyre çështjeve të cilat më së shumti i prekin OQ dhe bashkësitë; V) do të zbatojë sistem konsultativ profesional për çështje të caktuara me rend të temave siç janë drejtësia, statusi i dobisë publike, kontabiliteti, tatimet, financimi, zhvillimi i bashkësisë; VI) vazhdimisht do të sigurojë informata, do të ndërtojë dhe azhurnojë baza të dhënave për OQ lokale, mundësi për mjete të pakthyeshme, organizata ombrellë dhe ekspertë në nivel të rrethit; VII) do të bashkëpunojë me OQ të ngjashme nga rajoni, qendra komunale për kërkesa etj. Në bashkëpunim me Bibliotekën e qytetit, gjithashtu dëshirojnë të vendosin bibliotekë qytetare (grumbullimi i librave, dokumenteve dhe materiale audio-vizuale).

### 3.1.3.2. Trupat për bashkëpunim

Në nivel lokal çështjet qytetare mund të delegohen në zyrë të veçantë qytetare, siç është rasti me Budapestin ose ato i zgjidh personi përgjegjës zyrtar (p.sh. që punon në Departamentin për kulturë), siç është rasti me Debrecen dhe Zentes.

**Zyra qytetare e kryeqytetit** – punon si pjesë e Departamentit për shërbime të shfrytëzuesve, ka dy të punësuar dhe kryen disa detyra, të cilat kanë të bëjnë me pjesëmarrjen qytetare. Gjatë punës së tyre, ata bashkëpunojnë me nëpunësit shtetëror të cilët punojnë në rajonet e Budapestit – nëse ekzistojnë<sup>34</sup>. Ai udhëheq me **Bazën e të dhënave** të veçantë që ekziston që nga viti 2005, që përfshinë më shumë se 1.500 OQ. Regjistrimi në këtë bazë të dhënave është kusht që të merret pjesë në tenderin që e shpall Komuna e Budapestit. Përparësia administrative e regjistrimit qëndron në atë se organizata nuk duhet vazhdimisht të parashtrijë anekse obliguese, duke marrë parasysh se ato

<sup>33</sup> Informatë e marrë nga Olga Virag (Olga Virág), person zyrtar për çështje rinore dhe qytetare

<sup>34</sup> Rreth 75% të komunave rrethe kanë persona zyrtar përgjegjës për çështje qytetare dhe shumica prej tyre njëkohësisht kryejnë edhe detyra tjera. Informata u dha nga ana e Zyrës qytetare

deponohen në Zyrën qytetare gjatë regjistrimit. Baza e të dhënave gjithashtu shfrytëzohet për dërgimin e buletineve në bazë të rregullt dhe për ndihmë OQ që ta gjejnë partnerin e tyre adekuat në qytet.

Gjithashtu, Zyra qytetare e koordinon punën e punëtorive profesionale qytetare, të cilat janë formuar në fusha të ndryshme, siç janë ato për çështje sociale, mbrojtje shëndetësore, mbrojtja e ambientit jetësor, arsimimi dhe çështje të tjera. Organizatat qytetare mund të inkuadrohen në punëtoritë në procedurën për akreditim. Zyra qytetare siguron informata lidhur me tenderët në rrjedhë dhe për shkak të informimit adekuat për udhëheqje dhe azhurnim të **Faqes qytetare** në internet faqen e Komunës së Budapestit.

Dekreti i Komunës së Budapestit (i përmendur më sipër) në nenin 4(1) e përshkruan procedurën për dorëzimin e komenteve përmes Faqes qytetare. Në internet faqen dorëzohet propozim dokumenti i Kuvendit gjeneral, i cili i prek qytetarët, me atë që OQ u jepet 15 ditë që të japin mendim. OQ mund të dërgojnë mendime dhe të dërgojnë sugjerime përmes internet faqes, ndërsa personi përgjegjës për përgatitjen e propozimit duhet ta analizojë mendimin e arritur dhe të jep pasqyrë të shkurtër, që duhet të shpallet në afat prej 21 ditëve. Personi nuk duhet të përgjigjet konkretisht çdo letre.


**Budapestportal**Keresés

- Hírek
- Város
- Önkormányzat
- Kisebbségi oldal
- Szolgáltatás
- Programok
- Civil Oldal
- E-ügyintézés
- E-információs adatok - Kérdések és válaszok
- A Főváros sportja

- Városházi hírek
- Budapesti hírek
- Kerületi hírek
- Kulturális hírek
- Kék hírek
- Közlekedési hírek
- Időjárás
- Lap- és blogszemle
- Sajtóesemények, meghívók



- [+] Ügyfélszolgálat
- [+] Fórum
- [+] Regisztráció
- [+] Keresés
- [+] Sitemap
- [+] Linkgyűjtemény
- [+] English
- [+] Deutsch
- [+] Français

**Civil Oldal : Civil Szakmai Műhelyek**

- [+] [Civil Szakmai Műhelyek](#)
- [+] [Civil hírek](#)
- [+] [Fővárosi Civil Iroda](#)
- [+] [Fővárosi Civil Adatbázis](#)
- [+] [A Fővárosi Önkormányzat Civil Nyilatkozata és Civil Rendelete](#)
- [+] [A Nemzeti Civil Alapprogram törvény szövege](#)
- [+] [Tanulmányok és esszék a nonprofit szektorról](#)
- [+] [Tudnivalók](#)
- [+] [Linkek](#)
- [+] [Civil EU](#)
- [+] [Pályázatok civil szervezetek részére](#)
- [+] [Motiváció Alapítvány](#)

### Civil Szakmai Műhelyek

**Budapest Fővárosi Közgyűlésének 61/2008. (XI.21.) számú a Fővárosi Önkormányzat és a fővárosi civil szervezetek kapcsolatrendszerének egyes kérdéseiről, pályázati rendszeréről szóló önkormányzati rendelete (Civil Rendelet) nyomán, Budapest Főváros Főpolgármesteri Hivatala szakmai műhelyek felállítását kezdeményezte az alábbi területeken: időügyi, fogyatékos-ügyi, drogügyi, hajléktalanügyi, szociális, egészségügyi, környezetvédelmi, városfejlesztési, városüzemeltetési, oktatási, kulturális, sport.**

A civil műhelyek célja szakmai, ágazati kérdések, problémák megvitatása, valamint a közösen elfogadott álláspontok megjelenítése a Fővárosi Önkormányzat döntéseiben.

**Az alábbi műhelyek alakultak meg: Fogyatékos-ügy, Kulturális, Sport, Oktatás, Környezetvédelem, Városfejlesztés, Egészségügy, és Szociális.**

**A műhelyek munkájához folyamatosan lehet csatlakozni! A jelentkezési lap [itt](#) tölthető le.**

Bővebb felvilágosítás a Fővárosi Civil Irodán    Telefon: 327- 12-11

CIVIL SZAKMAI MŰHELY	ELNÖK
Szociális	Gosztonyi Géza
Városfejlesztés	Árpalma László

**Legfrissebb hírek:**

- [+] [Közös megegyezéssel távozik a BKV vezérigazgatója](#)
- [+] [Tarlós István főpolgármester reagálása Tóth Ákosnak a Népszabadságban megjelent "Tarlós imája" című cikkére](#)
- [+] [Nővényünnep és Vidám doboznapok az Állatkertben - Tíz italos kartondoboz most qyermekiegyvet ér](#)
- [+] [Forgalomkorlátozás várható a XXI. kerületi Weiss Manfréd úton](#)
- [+] [Több ezren a 26. Budapesti Nemzetközi Félmaratonon](#)

### **Faqja qytetare i përfshinë lajmet dhe informatat më të reja për këto tema kryesore:**

- ✓ Punëtori qytetare profesionale;
- ✓ Lajme qytetare;
- ✓ Bazë qytetare e të dhënave të kryeqytetit;
- ✓ Deklaratë qytetare e vetëqeverisje lokale të Budapestit dhe Dekreti qytetar;
- ✓ Teksti i Aktit për fond qytetar nacional<sup>35</sup>;
- ✓ Pasqyrë dhe ese për sektorin jofitimprurës (në tema prej 1% donacion, statistika, aktivitete të OQ, hulumtime ndërkombëtare dhe hulumtime për BE, partneritete, vullnetarizëm, tenderë, çështjet juridike, udhëheqje);
- ✓ Rregullore adekuate ligjore;
- ✓ Lidhje me portale tjera të dobishme për organizatat qytetare;
- ✓ Tenderë për organizatat qytetare (duke përfshirë edhe tenderët të fondit qytetar nacional, si dhe fondacion publik dhe organizata private);
- ✓ Lidhje qytetare me BE (duke përfshirë pika mes BE dhe organizatave qytetare dhe internet faqet adekuate).

Në rast të qyteteve dhe fshatrave më të vogla, informatat që jepen në internet faqe zakonisht kanë më pak hollësi dhe janë mjaft të kufizuara dhe i cekin vetëm OQO lokale. Por ata shfrytëzojnë forma tjera që të arrijnë deri te shoqëria civile, për shembull, në rastin e Zentes ato OQ të regjistruara në bazën e të dhënave të pushtetit lokal, rregullisht informohen për mundësitë për financim, konferenca dhe çështje tjera adekuate përmes e-postës, ndërsa të gjitha OQ marrin letër përmes postës, të cilat kanë të bëjnë me çështje që kanë të bëjnë me të gjithë.<sup>36</sup>

#### **3.1.3.3. Financimi**

Sipas Strategjisë qytetare, sektori civil hungarez në vitin 2003 ishte më pak i financuar nga ana e qeverisë dhe pushtetit lokal, gjithashtu, shpërndarja e mjeteve buxhetore nuk ishte e balancuar. Në 10 vitet e kaluara madhësia e të ardhurave nga mjetet shtetërore dukshëm u rrit. Edhe krahas asaj që financimi shtetëror (duke përfshirë edhe ndihmën që vjen nga buxheti qendror dhe vetëqeverisjes lokale, 1%, të ardhurat nga TVSH-ka e kthyer) në vitin 2000 ishte 28%, në vitin 2008 kjo u rrit në 44%. Por, në rastin e të ashtuquajturave OQ klasike (fondacione dhe asociacione), shkalla ishte vetëm 35%.<sup>37</sup> Marrë në përgjithësi, 30.507.400,000 FHU<sup>38</sup> ishte mbështetja qeveritare lokale në vitin 2008, që është e barabartë me 7,4% nga të ardhurat e përgjithshme të OQ.

Komuna siguron mjete për zbatimin e detyrave obliguese dhe këtë e shfaq në buxhetin vjetor me pasqyrë të organizatave dhe shumave. Krahas kësaj, Komuna jep mjete të pakthyeshme për projekte të ndryshme nga të ashtuquajturat buxhete të këshillit. Komuna ka buxhet të veçantë për mundësi të barabarta dhe çështje qytetare, të cilat së bashkë janë 75 milionë FHU në vitin 2010. Nga kjo shumë, 35 milionë FHU ishin të dedikuara për qëllimin mundësi të barabarta, ndërsa 50 milionë FHU shërbyen për çështje qytetare. Ekzistojnë edhe buxhete të tjera të këshillit (kulturë, sport, mbrojtja e ambientit jetësor etj.) të cilat kanë tenderë që janë në dispozicion të OQ.

Vlen të përmendet se fondi qytetar nacional gjithashtu mbështet dialogun lokal me çka sigurohet mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve të OQ dhe avancimin e bashkëpunimit të tyre. Për shembull, Fondi shpall thirrje për tender në fillim të këtij viti me qëllim që të forcohen bashkësitë lokale dhe aleancat profesionale përmes

<sup>35</sup> Fondi qytetar nacional ka për qëllim ta forcojë punën e OQ dhe zhvillimin e sektorit të tretë përmes mbështetjes me mjete të pakthyeshme. Mjetet e pakthyeshme i distribuojnë këshillat e përbërë nga përfaqësues të organizatave qytetare. Parimet e sistemit të mbështetjes-mjetet e pakthyeshme janë caktuar nga ana e Këshillit që ka shumicë delegatë nga OQ.

<sup>36</sup> Informata u mor nga Olga Virag (Olga Virág), person zyrtar përgjegjës për çështje rinore dhe qytetare.

<sup>37</sup> Enti qendror për statistikë i Hungarisë (2010): Organizata jofitimprurëse në Hungari 2008. Enti qendror për statistikë i Hungarisë, Budapest.

<sup>38</sup> Që është e barabartë me 115.470 euro, sipas listës së kursit të bankës qendrore nga 6 qershori 2011

mbështetjes së pjesëmarrjes qytetare dhe aksioneve të qytetarëve. Shpërndarja e mjeteve të disponueshme<sup>39</sup> ka të bëjë me iniciativën për bashkëpunim territorial dhe profesional dhe mbështetja e formave tjera të aktivitetit, me të cilat avancohet aktiviteti i përbashkët i OQ.<sup>40</sup> Kërkuesi do të bashkëpunojë me më së paku dy organizata të cilat janë të regjistruara nga ana e gjykatës dhe do ta dorëzojë marrëveshjen për bashkëpunim të kyçur mes tyre. Rezultatet e pritura do të vlerësohen në bazë të këtyre kritereve: I) partnerët të cilët bashkëpunojnë; II) organizatat e prekura nga bashkëpunimi qytetar; III) bashkëpunimi i ri; IV) ngjarjet të cilat i shërbejnë bashkëpunimit; V) pjesëmarrës në programe (konferenca, seminare); VI) ekspertë të mbështetur nga programi; VII) prodhime të cilat e risin bashkëpunimin e fituar gjatë projektit.

#### 3.1.3.4. Model tjetër

E ashtuquajtura **“Lëvizja tele shtëpia”** gjithashtu është shembull i shkëlqyeshëm për bashkëpunimin ndër sektorial në nivel lokal, ku janë inkuadruar në mënyrë të barabartë edhe vetëqeverisjet lokale dhe OQ. Kjo ka për qëllim ta zhvillojë dhe ta formojë bashkësinë, pastaj ta përmirësojë kualitetin e jetës së banorëve, me çka do të sigurohet hapësirë për organizimin e programeve të bashkësisë, mjete dhe ndihmë për administrim të përditshëm (p.sh. qasje deri në internet). Lëvizja e pranuar në botë doli nga një iniciativë qytetare në vitin 1995 kur 15 persona privat e themeluan Lidhjen hungareze të Tele shtëpia në Hungari. Tele shtëpitë e parë u formuan në vitin 1994 dhe sot ka rreth 606 tele shtëpia të regjistruar në vend. Në 5 vitet e para lëvizjen e mbështeste USAID, ish Ministria e Telekomunikacionit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Edhe krahas asaj që tele shtëpitë përkohësisht kryejnë detyra publike, ata nuk marrin mjete shtetërore.

Së pari, bashkësitë e fshatrave më të vogla formojnë tele shtëpi, pasi që kuptuan se kjo është bazë e mirë dhe vegël që të zgjidhen problemet e bashkësisë lokale (p.sh. përgatitja e tenderëve, organizimi i ngjarjeve, përgatitja e planeve për zhvillim, organizimi i trajnimeve). Çdo muaj formohen 2-3 tele shtëpi të ri dhe tani mund të arrijnë deri 2,5 milionë persona të rrezikuar socialist në gjithë vendin.

Sot me shumicën e teled shtëpitë punojnë organizata qytetare, por ka edhe shumë të tjera të cilat janë pronësi e vetëqeverisjeve lokale, institucioneve lokale ose ndërmarrjeve lokale. Por, suksesi i tele shtëpitë në të gjitha dhe në çdo rast të veçantë varet nga bashkëpunimi i vetëqeverisjes lokale, OQ dhe sektori afarist.

Lidhje hungareze e tele shtëpitë e cakton standardin minimal si kusht që të përdoret “Tele shtëpi”. Ekziston minimumi i shërbimeve (internet, e-posta, përdorimi i kompjuterit dhe faksit, ndihmë për administrim, vëzhgimi i mjeteve të pakthyeshme, organizimi i trajnimeve, shërbimi për OQ, sigurimi i informatave për shërbime komunale publike, qendra lokale për reklamim, kryerja e punëve me kompjuter etj.), minimumi teknik (qasje deri te interneti, telefoni, rrjeti kompjuterik, printeri i CD, skaneri, printeri etj.) dhe minimumi operativ (kontrolli qytetar, 1 i punësuar, 2 zyra, tualeti, mobilet, lista e çmimeve e publikuar, më së paku 20 orë e hapur/në javë, sigurimi, adresa postare, rregullat operative etj.)<sup>41</sup>

<sup>39</sup> Rreth 60 milionë FHU, që është e barabartë me 226.031 euro, sipas listës së kursit të Bankës qendrore nga 6 qersori 2011

<sup>40</sup> <http://www.wekerle.gov.hu/?kinek=1844&cikkid=616>

<sup>41</sup> Informata plotësuese për lëvizjen tele shtëpi mund të gjeni në internet faqen: <http://www.telehaz.hu/>

## 3.2. BOSNJA DHE HERCEGOVINA (BeH)

### 3.2.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale në Bosnjë dhe Hercegovinë

Bosnja dhe Hercegovina është e ndarë në dy entitete: Republika Serbe dhe Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës. Niveli i tretë i nënndarjes politike e Bosnjës dhe Hercegovinës janë kantonet dhe entiteti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës që ka gjithsej 10 kantone. Të gjitha kantonet kanë vetëqeverisje të vet, që është sipas ligjit për Federatën në tërësi. Niveli i katërt i ndarjes politike së Bosnjës dhe Hercegovinës është ajo komunale. Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës është ndarë në 74 komuna dhe Republika Serbe në 63. Gjithashtu komunat kanë pushtet të tyre dhe në mënyrë tipike janë vendosur rreth qytetit më të rëndësishëm ose vendit të territorit të tyre. Administrimi lokal në përgjithësi është më efektiv se sa nivelet tjera të administrimit, por kjo është e kufizuar në pikëpamje të kompetencave dhe financave të kantoneve në federatën boshnjake-kroate të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe strukturës së centralizuar të qeverisë në Republikën Serbe.<sup>42</sup>

### 3.2.2. Dispozitat ligjore

Në **Kushtetutën e Bosnjës dhe Hercegovinës** nuk mund të gjenden rrënjët e pjesëmarrjes qytetare.<sup>43</sup> Por, në BeH janë zhvilluar disa marrëveshje mes autoriteteve dhe sektorit të tretë, si dhe një komplet i rregullave për konsultim publik në nivel shtetëror.

**Dispozitat për konsultim gjatë përgatitjes së propozim-legjislacionit** të miratuara në vitin 2006<sup>44</sup> rezultuan me disa OQ të suksesshme të cilat morën pjesë në përgatitjen e legjislacionit. Rregullorja vendosi obligim për konsultim minimal që duhet të plotësohet bile edhe në rrethana të jashtëzakonshme. Në pajtim me nenin 1 nga Rregullorja, të gjitha ministratë edhe institucionet tjera në Bosnjë dhe Hercegovinë do të ndjekin procedurat për konsultim kur përgatitet propozim legjislacioni. Pa marrë parasysh këtë, përmbajtja e Rregullores qartë njofton se rregullorja aplikohet vetëm për propozim legjislacion të tillë që është dorëzuar deri te Këshilli i ministrave dhe i miratuar nga ana e Kuvendit parlamentar, e sipas këtij legjislacioni në nivel lokal është përjashtuar.

**Ligji për parimet për vetëqeverisje lokale e Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës** nga viti 2006 rregullon se në mbledhjet e këshillit mund të marrin pjesë qytetarë në mënyra dhe sipas kushteve të rregulluara në kushtet për punë në pajtim me ligjin. Lajmërimi dhe informatat për punën e organeve të njëjësive të vetëqeverisjes lokale mund të jepen nga ana e përfaqësuesve të shefit të njëjësive dhe përfaqësuesve të këshillit. Me qëllim që opinioni të informohet, trupat e njëjësive të vetëqeverisjes lokale do të dorëzojnë raporte vjetore publike, ku rezultatet do të krahasohen me qëllimet e planifikuara programore. Pjesa IX nga ligji përmban dispozita të cilat kanë të bëjnë me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në proceset e vendimmarrjes. Sipas nenit 43, qytetarët mund të vendosin në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështje të cilat janë në suaza të vetëqeverisjeve lokale me anë të referendumit, shoqërimit lokal të qytetarëve dhe formave tjera të deklaramit të drejtpërdrejtë të vullnetit. Procesi dhe procedurat për vendosje të drejtpërdrejtë duhet të rregullohen me ligj dhe statut. *“Qytetarët do të vendosin propozimet e veta përmes iniciativave qytetare, shoqatat e qytetarëve, organizatat joqeveritare ose në cilëndo qoftë mënyrë që mund të rregullohet me statut. Njësitë e vetëqeverisjes lokale mund të vendosin çfarëdo mekanizma të demokracisë së pjesëmarrjes derisa ata nuk ndalohen me ligj”.*

<sup>42</sup> [http://lgi.osi.hu/country\\_datasheet.php?id=22](http://lgi.osi.hu/country_datasheet.php?id=22)

<sup>43</sup> Teksti i Kushtetutës mund të gjendet në lidhjen më poshtë: [http://www.ccbh.ba/public/down/USTAV\\_BOSNE\\_I\\_HERCEGOVINE\\_engl.pdf](http://www.ccbh.ba/public/down/USTAV_BOSNE_I_HERCEGOVINE_engl.pdf)

<sup>44</sup> Teksti i Kushtetutës mund të gjendet në lidhjen më poshtë: [http://www.mpr.gov.ba/userfiles/file/Javne%20konsultacije/BiH\\_Regulations\\_Consultations\\_LegislativeDrafting\\_2006%5B1%5D.pdf](http://www.mpr.gov.ba/userfiles/file/Javne%20konsultacije/BiH_Regulations_Consultations_LegislativeDrafting_2006%5B1%5D.pdf)

Gjithashtu, u miratua edhe rregullorja për zbatimin e tij: <http://www.mpr.gov.ba/userfiles/file/Javne%20konsultacije/EJ%20Pravilnik%20za%20konsultacije.pdf>



**Ligji për vetëqeverisje lokale e Republikës Serbe** nga viti 2004 përmban kapitull të veçantë për pjesëmarrjen qytetare. Ligji i numëron këto forma të pjesëmarrjes: referendumi, shoqërimi qytetar, panelet e qytetarëve, orët e qytetarëve. Neni 100 nga Ligji rregullon se qytetarët kanë të drejtë të ngrenë iniciativë për miratimin ose plotësimin e rregullave të cilat janë kompetencë të vetëqeverisjes lokale.

### 3.2.3. Instrumentet për bashkëpunim në nivel lokal

#### 3.2.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale

Në vitin 2007 Këshilli i ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës (BeH) e miratoi **Marrëveshjen për bashkëpunim mes Këshillit të ministrave të BeH dhe sektorit civil** në Bosnjë dhe Hercegovinë, pas çka vijoi zgjedhja e 31 anëtarëve të Këshillit për shoqëri civile në tetor të vitit të njëjtë. Miratimi i këtij dokumenti është rezultat i iniciativës më intensive nga ana e një koalicioni të OQ në nivel të vendit, të quajtur “Të punohet dhe të arrihet bashkërisht”, e koordinuar nga ana e Qendrës për Avancimin e Shoqërisë Civile (CKGO). Iniciativa filloi në vitin 2004 me qëllim që të krijohen mekanizma për bashkëpunim në nivel lokal dhe nacional. Puna e marrëveshjes nacionale zbatohet paralelisht me aktivitetet për miratimin e dokumenteve të tilla në nivel lokal. Si rezultat i kësaj, 67 komuna nënshkruan marrëveshje nga viti 2009<sup>45</sup>. Koalicioni i OQ zhvilloi model për marrëveshje që mund të shfrytëzohet si bazë nga ana e komunave. Nuk ekzistojnë marrëveshje në nivel të entiteteve.

Shembull për dokument politik në nivel lokal është **Marrëveshja për bashkëpunim me qeverinë e Kantonit Sarajevë**, e miratuar në vitin 2010, si rezultat i iniciativës të rrjetit të OQ “Marrëveshja plus”. Qëllimi kryesor i Marrëveshjes është ti avancojë interesat publike zhvillim më të fuqishëm të resurseve lokale përmes dialogut dhe marrëveshjes me OQ, me çka do të përmirësohet kualiteti i përgjithshëm i jetës për të gjithë qytetarët e Kantonit Sarajevë.

*(1) Qeveria kantonale dhe OQ e shprehin gatishmërinë e tyre të punojnë drejt arritjes së këtyre qëllimeve kryesore:*

*Avancimi i dialogut dhe bashkëpunimit të përbashkët gjatë planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët të Sarajevës;*

- b. Rritja e shkallës së respektit të përbashkët dhe vlerësimi i roleve konkrete dhe përgjegjësi të cilat i ka Qeveria e kantonit dhe sektorit të OQ për zhvillimin e Kantonit dhe dobia e gjithë qytetarëve të tij;*
- c. Pjesëmarrja e rritur e qytetarëve dhe OQ në vendimmarrje dhe politikën publike nga përfshirja e përgjegjësi dhe autorizimeve të Kantonit të Sarajevës;*
- ç. Planifikimi i mjeteve të pakthyeshme dhe financimi i zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të OQ në Kantonin e Sarajevës;*
- d. Avancimi dhe mbështetja e shoqërimit të lirë të qytetarëve që ti mbrojnë të drejtat e tyre dhe intereset dhe zhvillimi i shtetësisë aktive;*
- dh. Mbështetja për zhvillimin e punës vullnetare, filantropia individuale dhe korporatave, solidariteti social dhe kapitali social;*
- e. Sigurimi i sinergjive për qeverinë e kantonit dhe sektorit të OQ në procesin e integritetit evropian;*
- ë. Përfaqësimi i përbashkët dhe lobimi nga ana e autoriteteve më të larta në nivel të entitetit dhe në nivel shtetëror që të zgjidhen problemet qytetare.*

*(2) Këto qëllime do të realizohen përmes përgatitjes dhe miratimit të kodeksit të praktikës së mirë (rregullave) të cilat pas miratimit të tij, do të llogaritet si pjesë përbërëse e kësaj marrëveshje.*

Marrëveshja i cek parimet e bashkëpunimit, të drejtat dhe obligimet e pushtetit lokal, por gjithashtu edhe ato të OQ, si dhe hapat e marra vesh që të sigurohet zbatimi i Marrëveshjes në praktikë. Krahas kësaj, ajo vendos një trup ndër sektorial, që është përgjegjës që të vëzhgohet zbatimi (shih më poshtë). Pritet që Marrëveshja të vlerësohet

<sup>45</sup> TAKSO, Bosnjë dhe Hercegovinë për vlerësimin e nevojave, 2010



një herë në vjet përmes mbledhjes vjetore me OQ. Përfundimet dhe raporti nga kjo mbledhje do të shërbejnë për zhvillimin e planit aksionar për vitin e ardhshëm.

### 3.2.3.2. Trupat për bashkëpunim

Tridhjetë e një (31) komunë kanë formuar trupa të përbashkët, të cilat përbëhen prej përfaqësuesve të vetëqeverisjeve lokale dhe përfaqësuesve të sektorit civil, të cilat kryesisht janë dedikuar që ti caktojnë prioritetet të OQ lokale, me qëllim që tu jepet mbështetje përmes fondeve të pushtetit lokal.<sup>46</sup>

Për shembull, Marrëveshja me Kantonin Sarajevë rregullon formimin e **këshillit për bashkëpunim** ndër sektorial.

*Qëllimi dhe funksionimi i Këshillit:*

*Zhvillimi dhe miratimi i planeve vjetore aksionare për zbatimin e marrëveshjes, bashkë me planin për vëzhgim dhe vlerësim;*

- b. Caktimi i rekomandimeve për drejtimet strategjike për zhvillimin e shoqërisë civile në Kanton;*
- c. Koordinimi i aktivitetit në kuadër dhe mes qeverisë kantonale dhe OQ për zbatimin e Marrëveshjes;*
- ç. Kërkesa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kontesteve që do të mund të paraqiten mes përfaqësuesve të palëve në procesin e zbatimit të Marrëveshjes;*
- d. Planifikimi dhe organizimi i mbledhjes vjetore (forum) të përfaqësuesve të qeverisë së Kantonit dhe organizatave joqeveritare që të vlerësohen rezultatet e arritura gjatë zbatimit të Marrëveshjes dhe vendosja e kornizës për plan aksionar për vitin e ardhshëm;*
- dh. Caktimi i rekomandimeve për amendamentet e Marrëveshjes;*
- e. Përgatitja e raporteve vjetore për aktivitetet e tyre dhe zbatimi i Marrëveshjes dhe dorëzimi i tyre për miratim deri te Qeveria dhe Parlamenti i kantonit dhe rrejtit të OQ "Marrëveshja plus" – Kantoni Sarajevë...*

Këshilli është përbërë prej 26 anëtarëve, prej të cilëve 13 janë përfaqësues të qeverisë së kantonit dhe 13 nga OQ (përfaqësues të rrejtit Marrëveshja plus). Është paraparë që një person nga qeveria e kantonit për marrëdhënie me OQ të sigurojë mbështetje teknike në punën e Këshillit. Para do kohe rrjeti i OQ Marrëveshja plus solli vendim për mënyrën dhe procedurën për propozim të kandidatëve për anëtarë të Këshillit.<sup>47</sup>

### 3.2.3.3. Financimi

Sipas Indeksit të qëndrueshmërisë nga viti 2009 i publikuar nga ana e USAID, mekanizmat lokale për mbështetje akoma janë më të dëshiruara si dhe instrumentet e reja të BE për financim, paraqesin sfidë për OQ, duke marrë parasysh mospasjes e tyre të përvojës relevante dhe mungesa e shkathtësive në krahasim me organizatat e mëdha rajonale dhe ndërkombëtare. Vetëm organizatat të cilat nuk paraqesin kërcënim politik firojnë mbështetje nga pushteti lokal.<sup>48</sup>

Mbështetja e jashtme shtetërore luajti rol të rëndësishëm në financimin e OQ gjatë disa viteve të kaluara. Për shembull, Qeveria e SHBA u dha 68 OQ boshnjake mjete të vogla të pakthyeshme, që të zbatohen fushata për avokim me qëllim që të avancohet pjesëmarrja aktive në procesin demokratik.

<sup>46</sup> TAKSO, Bosnjë dhe Hercegovinë për vlerësimin e nevojave, 2010

<sup>47</sup> <http://www.sporazum.ba/>

<sup>48</sup> USAID: Indeksi i qëndrueshmërisë së OQ nga viti 2009. Faqja 74. Megjithatë, nënshkrimi i Marrëveshjes nacionale për bashkëpunim me sektorin e OQ duket se rezultoi vetëm me një përparim të vogël në rrethimin juridik të OQ në BeH. Sipas Indeksit të qëndrueshmërisë së OQ nga viti 2009, pjesëmarrja në vendimmarrje akoma është e pamjaftueshme dhe ad hok, gjithashtu edhe qeveria deh sektori i OQ nuk kanë njohuri të mjaftueshme për mekanizmat ekzistuese për pjesëmarrje të OQ.

## 3.3. KROACIA

### 3.3.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale në Kroaci

Ekzistojnë dy nivele të pushtetit subnacional: qytete dhe komuna në nivel të vetëqeverisjes lokale, dhe rrethet si njësi të vetëqeverisjes rajonale. Ekzistojnë 20 njësi të vetëqeverisjeve lokale dhe qyteti i Zagrebit, 126 qytete dhe 429 komuna.

Çdo pushtet lokal dhe rajonal ka statusin e vet që i rregullon të drejtat dhe obligimet e pushteteve lokale dhe rajonale publike *inter alia* format e konsultimit të qytetarëve dhe format e bashkëpunimit. Qytetarët janë inkuadruar në procesin e vendimmarrjes përmes debateve publike, konsultimit dhe organizimit lokal ose rajonal të referendumeve.<sup>49</sup> Ajo që është e rëndësishme se shumica e vetëqeverisjeve lokale dhe rajonale kanë mjete të rëndësishme për financim. Nga vendet e Ballkanit, Kroacia mund të llogaritet si vend me bashkëpunim më të gjatë dhe më të zhvilluar në nivel nacional dhe lokal.

### 3.3.2. Dispozitat ligjore

**Kushtetuta e Republikës së Kroacisë**<sup>50</sup> i vendos bazat për pjesëmarrje qytetare në nivel lokal.

#### **Neni 133**

*“Qytetarëve u garantohet e drejta e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale.*

*E drejta e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale realizohet përmes trupave përfaqësuese lokale dhe/ose rajonale, të përbëra prej anëtarëve të zgjedhur në zgjedhje të lira me vota të fshehta në bazë të votimit të drejtpërdrejtë, të barabartë dhe të përgjithshëm.*

**Qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të marrin pjesë në kryerjen e punëve lokale përmes mbledhjeve, referendumit dhe formave tjera të vendosjes së drejtpërdrejtë, në pajtim me ligjin dhe dekretet lokale.**

*Të drejtat e caktuara në këtë nen do të realizohen nga ana e shtetasve të Bashkimit Evropian në pajtim me ligjin dhe *acquis communautaire* të BE”.*

**Ligji për vetëqeverisje lokale dhe rajonale** i kushton kapitull të veçantë (IV) rregullave për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë qytetarëve në vendimmarrje. Kjo përfshinë rregulla të hollësishme për procedurën për zbatimin e referendumit, propozim i qytetarëve që të sillt akt i veçantë nënligjor ose të shqyrtohet çështje e caktuar në përfshirjen e tyre, rregulla për parashtrimin e ankesave për punën e trupave të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale.<sup>51</sup> Por, ligji nuk përfshinë rregulla konkrete e as konsultim gjatë procedurës ligjdhënëse, e as për forma tjera të pjesëmarrjes qytetare. Në vend të kësaj, këtë e la të rregullohet me statutet e vetëqeverisjeve lokale dhe rajonale.

**Akti për të drejtën e qasjes deri te informatat** i cakton rregullat e nivelit të parë të pjesëmarrjes publike: qasje deri te informatat. Trupat e njësisve të vetëqeverisjeve lokale dhe rajonale gjithashtu janë obliguar që të mbahen ndaj rregullave dhe të lejojnë qasje deri te informatat e kërkuara ose ti marrin në raste konkrete. Akti rregullon 5 mënyra për dhënien e informatave: I) dhënia e rregullt e informatave të caktuara; II) sigurimi i drejtpërdrejtë i informatave personit që i kërkon; III) lejimi i qasjes deri te dokumentet; IV) dorëzimi i dokumenteve, duke përfshirë edhe informatat

<sup>49</sup> [http://lgi.osi.hu/country\\_datasheet.php?id=42](http://lgi.osi.hu/country_datasheet.php?id=42)

<sup>50</sup> Kushtetuta mund të gjendet në internet faqen: <http://www.sabor.hr/Default.aspx?art=2405>

<sup>51</sup> Ligji për vetëqeverisje lokale dhe rajonale u miratua në vitin 2001 dhe prej atëherë është plotësuar disa herë: [http://udruga-opcina.hr/universalis/889/pdf/zakonolokalnojipodrucnoj\\_regionalnoj\\_samoupravi-prociscenitekst\\_1952956072.pdf](http://udruga-opcina.hr/universalis/889/pdf/zakonolokalnojipodrucnoj_regionalnoj_samoupravi-prociscenitekst_1952956072.pdf)

e kërkuara drejtpërdrejtë personit që i kërkon; V) në mënyrë tjetër. Trupat për koordinim të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale gjithashtu do të sigurojnë qasje të drejtpërdrejtë deri te aktivitetet e tyre, mbledhjet dhe deri te rendi i ditës, procedura për kërkesë dhe numri i njerëzve të cilët mund të jenë të pranishëm, do të shpallet më herët. Gjithashtu, ata janë të obliguar të propozojnë nga një person përgjegjës, i cili do të sigurojë informata, do ta përpunojë kërkesën e kërkuarit dhe do të udhëheq katalog të informatave.

### **Kodi për praktikumin e konsultimit me opinionin e interesuar në procedurën për miratimin e ligjeve, rregullave dhe akteve tjera (Kodi)<sup>52</sup>**

Ai i rregullon parimet, standardet dhe masat e përgjithshme për realizimin e konsultimeve me opinionin e interesuar, në procedurat për miratimin e ligjeve dhe rregullave dhe akteve tjera të organeve shtetërore, të cilat i rregullojnë punët dhe marrin qëndrime me interes për dobinë publike. Neni IX nga Kodi rregullon se dispozitat “në mënyrë adekuate aplikohen nga ana e organeve të njëjësive të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale dhe subjektet juridike me autorizime publike në procedurat për miratimin e akteve të përgjithshme, të cilat i rregullojnë çështjet në kuadër të fushës së tyre të veprimit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë i plotësojnë nevojat e qytetarëve, ose çështje tjera me interes për dobinë publike të qytetarëve dhe subjekteve juridike në kuadër të fushës së tyre të veprimit”. Pas miratimit të Kodit, Zyra qeveritare për bashkëpunim me shoqatat miratoi drejtime me qëllim që në mënyrë plotësuese ti sqarojë dispozitat nga dokumenti, ta rrisë kuptimin, dhe gjithashtu të sigurojë zbatim të harmonizuar nga ana e organeve të ndryshme përgjegjëse për aplikimin e tij. Kodi aplikohet ndaj opinionit të interesuar, që gjerë është definuar si: “qytetarë, OQ (grupe joformale qytetare ose iniciativa, shoqata, fondacione, fonde, institucione private, sindikata, shoqata të punëdhënësve), përfaqësues të bashkësisë akademike, odave, institucioneve publike dhe subjekteve tjera juridike të cilat kryejnë shërbim publik ose të cilat do të mund të prekeshin nga ligji, rregull tjetër që miratohet, ose që duhet të kyçet në zbatimin e tij”.

### **3.3.3. Instrumentet për pjesëmarrje dhe bashkëpunimi në nivel lokal**

Sipas vlerësimit të Strategjisë nacionale<sup>53</sup>, “nuk ekziston sistem gjithëpërfshirës, i caktuar strategjik ose operativ, i cili do të mundësojë organizatave qytetare të marrin pjesë si partnerë të barabartë dhe të kontribuojnë për zhvillimin e mjediseve lokale jetësore dhe rajoneve. Kjo njëlloj ka të bëjë me sistemin e financimit dhe sistemin për vendimmarrje dhe udhëheqja me zhvillimin... Akoma ka hapësirë që të harmonizohen praktikat e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale, me qëllim që të sigurohet procedurë e barabartë dhe transparente për financimin e shoqatave... Çështjet tjera, siç janë përcjellja e nevojave të organizatave qytetare, inkuadrimi në planifikimin e zhvillimit, zbatimin e programeve, e veçanërisht planifikimi i buxheteve publike, akoma nuk kanë kornizë adekuate institucionale”.<sup>54</sup>

Sipas Indeksit të qëndrueshmërisë nga viti 2009 i USAID, autoritetet nacionale dhe lokale vazhdojnë të bashkëpunojnë, por procesi konsultativ pushtet-OQ akoma është çështje prioritare për këtë sektor. Sipas vlerësimit, pengesat kryesore për vendosjen e partneritetit më të fuqishëm është ndikimi i dobët i OQ në procesin e vendimmarrjes, mungesa e kapacitetit dhe interesimi të pushteti lokal, qëndrueshmëria jo e sigurt e OQ dhe mungesa e personelit të trajnuar si në OQ, ashtu edhe në Qeveri.<sup>55</sup>

#### **3.3.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale**

Njësitë për vetëqeverisje lokale dhe rajonale gjithashtu marrin pjesë në përgatitjen e **Strategjisë nacionale për krijimin e ambientit që mundëson zhvillimin e shoqërisë civile (nga viti 2006 deri 2011)**, e cila e analizon zhvillimin e shoqërisë civile në Kroaci dhe i artikulon qëllimet në nivel shtetëror dhe lokal. Strategjia nacionale i kushton pjesë të veçantë temës pjesëmarrja e qytetarëve në krijimin e politikës publike dhe i thekson qëllimet që vijojnë:

<sup>52</sup> Kodi u miratua nga Qeveria më 21 nëntor 2009, si rezultat i një procesi të gjerë të konsultimit që e zbatoi Zyra për bashkëpunim me shoqatat dhe Këshilli për zhvillim të shoqërisë civile me OQ të shumta.

<sup>53</sup> Strategjia nacionale për krijimin e rrethimit, që mundëson zhvillim të shoqërisë civile nga viti 2006 dhe 2011, e miratuar në mbledhjen e Qeverisë së republikës së Kroacisë. Kjo siguron drejtime themelore për qëllimet që qeveria përpiqet ti realizojë deri në vitin 2011 me qëllim ta përmirësojë ekzistuesen dhe të krijojë të re, kornizë financiare dhe institucionale në zhvillimin e shoqërisë civile dhe të krijojë rrethim që mundëson zhvillim të mëtejshëm të shoqërisë civile në Republikën e Kroacisë.

<sup>54</sup> Strategjia nacionale, fq 42-43

<sup>55</sup> USAID: Indeksi i qëndrueshmërisë së OQ nga viti 2009. Fq.90

- Të stimulojë zbatimin më të rregullt të mekanizmave ekzistuese dhe miratimi i masave të reja për opinion në punën si të përfaqësuesve, ashtu edhe të organeve ekzekutive të pushtetit publik në **të gjitha nivelet, duke përfshirë edhe kuvendet e rrethit, këshillat lokale dhe autoritetet lokale të qyteteve dhe komunave;**
- Ti përmirësojë mekanizmat për informim të qytetarëve përmes plotësimit dhe miratimit të ligjeve të reja, konventave dhe rregullave tjera të cilat e caktojnë të drejtën e qasjes deri te informatat dhe pjesëmarrja publike gjatë vendimmarrjes për çështje me interes publik;
- Të caktojë modele këshillëdhënëse për qytetarët, iniciativat qytetare dhe organizatat qytetare, si dhe mjete për pjesëmarrje gjatë miratimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave publike (Kodi i praktikave të mira për dhënien e këshillave);
- Ta forcojë sundimin e të drejtës dhe besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë përmes aplikimit të denjë të ligjeve dhe dhënies së informatave opinionit lidhur me punën dhe punën e shërbimeve dhe obligimeve publike;
- Të arrihet dialog social me organizatat qytetare përmes organeve ekzistuese ose përmes formimit të organeve dhe forumeve të reja, shoqërimi i përfaqësuesve të sektorit publik, fitimprurës dhe jofitimprurës, joqeveritar;
- Të avancohen dhe përmirësohen dispozitat ligjore të cilat kanë të bëjnë me pjesëmarrjen kushtetutese themelore të lirisë dhe të drejtën e tubimit publik, të qetë të qytetarëve;
- Të kontrollohet mundësia për financimin e programeve dhe projekteve të cilat e avancojnë demokracinë e pjesëmarrjes;
- Të vendosen në sistemin arsimor të Kroacisë përmbajtje arsimore të orientuara drejt miratimit të vlerave, qëndrimeve, njohurive dhe shkathtësive të domosdoshme për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në proceset demokratike politike;
- Të vendosen përmbajtje arsimore të cilat kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në programe për trajnim profesional të nëpunësve shtetëror në nivel lokal dhe nacional.

Në bazë të qëllimeve, *inter alia* në **Planin operativ për zbatim**, që u planifikua të zbatohet deri në vitin 2011 nga ana e qeverisë dhe i cili ndikon mbi pjesëmarrjen në nivel lokal, i formuluan këto masa konkrete:

- ✓ Përgatitja e kodit për praktikë të mirë për konsultim;
- ✓ Miratimi i amendamenteve të nevojshme në Aktin për qasje deri te informatat;
- ✓ Propozimi për formimin e forumit ekonomik social;
- ✓ Vendosja e përmbajtjeve të cilat kanë të bëjnë me demokracinë e pjesëmarrjes në programet qeveritare dhe trajnimet;
- ✓ Avancimi i vendosjes së raporteve partnere mes vetëqeverisjes lokale dhe OQ (marrëveshje për bashkëpunim); Nxitja që të formohen organe përgjegjëse për avancimin e partneritete mes OQ joqeveritare dhe vetëqeverisje lokale;
- ✓ Përgatitja e propozimit-kodeksit për praktikë të mirë, standarde dhe drejtime për dhënien e mjeteve për programe dhe projekte të OQ, me qëllim që të realizohet mbështetja financiare për programe dhe projekte të
- ✓ OQ në nivel nacional dhe lokal dhe përgatitja e programit për trajnim për zbatim;
- ✓ Përgatitja dhe zbatimi i programit
  - Për avancimin dhe dukshmërinë e praktikës së mirë të fushës së veprimit dhe partneritete tjera për zhvillimin në nivel lokal dhe rajonal;
  - Për zbatimin e tenderëve publik dhe ftesave për bashkëpunim si mbështetje në zhvillimin e kapaciteteve të OQ në nivel lokal dhe rajonal;
  - Për financim të decentralizuar të projekteve të OQ në nivel lokal dhe rajonal;
- ✓ Përgatitja e programeve për ndihmë teknike për njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe rajonale – përgatitja dhe menaxhimi me projekte, të zbatohen nga ana e OQ;
- ✓ Dizanimi, organizimi dhe mbështetja e projekteve të organizatave qytetare për trajnim në fushën e bashkëpunimit ndër sektorial për njësitë e vetëqeverisjes lokale edhe rajonale
- ✓ Përgatitja e analizës për inkuadrim të OQ në programet dhe projektet e BE për bashkëpunim tej kufitar dhe caktimi i prioriteteve për njësitë e vetëqeverisjes lokale në fushë.

Sipas Igor Vidak, shëf i zyrës për bashkëpunim me OQ, gjithashtu ekzistojnë karta lokale për bashkëpunim mes OQ dhe vetëqeverisjeve lokale.<sup>56</sup> Kartat për bashkëpunim mes tjerash janë miratuar edhe në Rjekë, Shibenik, Sisak, Zhupanjë, Beli Manastir, Belishçe.

Karta e parë e cila rregullon bashkëpunimin mes komunës dhe OQ lokale ishte miratuar nga Këshilli i qytetit të Rjekës në nëntor të vitit 2004. Procesin e filluan në vitin 2001, 5 OJQ aktive në Rjekë me mbështetje të USAID dhe Qendrës Ndërkombëtare për të Drejtë Jofitimprurëse (QNDJ). Qendra e vërteton politikën qytetare për OQ, duke theksuar transparencën gjatë financimit të aktiviteteve të OQ dhe tre shtyllat e bashkëpunimit – zhvillim dhe konsultim, informata dhe financim. Ajo rregullon krijimin e komitetit koordinues, që përbëhet prej përfaqësuesve të OQ dhe përfaqësuesve të pushtetit qytetar, që i cakton standardet për departamentet qytetare dhe aktivitetet financiare të OQ, duke siguruar shembuj, procedura dhe kritere objektive për vlerësimin e propozimeve për mjetet e pakthyeshme.<sup>57</sup>

Në vitin 2008 Kuvendi i qytetit të Sisakut gjithashtu miratoi **Kartë për bashkëpunim të qytetit të Sisakut dhe shoqatat**<sup>58</sup>, duke shprehur gatishmëri dhe dëshirë për zhvillim të një partneriteti njëjloj të barabartë me shoqatat e qytetarëve. Krahas kartës për bashkëpunim, Sisaku miratoi dokumente plotësuese të cilat përmbajnë dispozita për bashkëpunim me organizatat qytetare, siç janë nevojat nga programet publike dhe Aksioni komunal për të rinjtë.<sup>59</sup> Karta u zhvillua në bashkëpunim me shoqatat në qytet dhe çdo shoqatë mund ti inkuadrohet kartës në cilëndo kohë.<sup>60</sup> Qyteti në mënyrë aktive bashkëpunon me organizatat në zbatimin e projekteve.<sup>61</sup>

<sup>56</sup> Neva Nahtigal (2010): *Institucionalizimi i dialogut qytetar – pasqyrë e masave ekzistuese politike*. CNVOS, Slloveni

<sup>57</sup> Radost Toftisova, *Zbatimi i dokumenteve politike për bashkëpunim OJQ-Qeveri: leksionet e mësuara*. ICNL Vëllimi 8, botimi 1, nëntor 2005, SHBA.

<sup>58</sup> <http://www.sisak.hr/uploads/documents/povelja-o-suradnji-gradana-siska-i-udruga-gradana.pdf>

<sup>59</sup> Siç është përshkruar në raportin për hulumtim të LOTUS, i zhvilluar nga GONG dhe shoqata e qyteteve të Kroacisë, 2009

<sup>60</sup> Lista e organizatave të cilat janë inkuadruar në Kartën mund të gjenden në:

[www.sisak.hr/uploads/documents/Udruge-koje-su-pristupile-Povelji-o-suradnji-Grada-Siska-i-udruga-graana1.pdf](http://www.sisak.hr/uploads/documents/Udruge-koje-su-pristupile-Povelji-o-suradnji-Grada-Siska-i-udruga-graana1.pdf)

<sup>61</sup> [www.sisak.hr/clanak\\_/7062/kvalitetno-partnerstvo-izmedu-gradana-siska-i-sisackog-ald-a](http://www.sisak.hr/clanak_/7062/kvalitetno-partnerstvo-izmedu-gradana-siska-i-sisackog-ald-a)

Karta bazohet mbi këto parime:

- ✓ Parimi i partneritetit të qytetit të Sisakut dhe asociacionet qytetare;
- ✓ Parimi i subsidiaritetit si bazë për partneritet;
- ✓ Parimi i pluralizmit të vlerës dhe orientimi drejt interesit;
- ✓ Parimi i transparencës në punën dhe aktivitetet;
- ✓ Parimi i autonomisë dhe pavarësia në punën e tyre;
- ✓ Parimi i përgjegjësisë së individit dhe shoqërisë.

### **Kapitulli III. FORMAT E BASHKËPUNIMIT**

Qyteti i Sisakut do të zhvillojë partneritet me shoqatat e qytetarëve përmes formave që vijojnë të bashkëpunimit: konsultimi; informimi; financimi.

Konsultimi do të bëhet përmes:

- Zhvillimi i mekanizmave efektiv të cilët do të mundësojnë pjesëmarrje aktive të qytetarëve, organizatave qytetare dhe iniciativa joformale qytetare në procesin e vendimmarrjes dhe do ti plotësojë nevojat e bashkësisë;
- Shqyrtimi i propozimeve dhe sugjerimeve nga shoqatat e qytetarëve për përgatitjen e strategjive dhe programeve për zhvillim, si dhe dhënia e prioritetit të nevojës publike;
- Inkuadrimi i përfaqësuesve nga organizatat qytetare në organet punuese që të përgatiten dhe të revidohen propozimet për zhvillim të rëndësishëm të bashkësisë dhe shoqërisë civile.

Informimi arrihet përmes:

- Forcimi i dialogut dhe komunikimi i dyanshëm mes autoriteteve të qytetit dhe qytetarëve;
- Shkëmbimi i informatave të cilat janë të rëndësishme për zhvillimin e bashkësisë lokale dhe shoqërisë civile;
- Ndërtimi i sistemit informativ dhe sistemeve të ngjashme të cilat mundësojnë dhe e lehtësojnë realizimin e të drejtave të qytetarëve për qasje deri te informatat;
- Azhurnimi i lidhjeve të shoqatave të qytetarëve në internet faqen e Qytetit të Sisakut.

Financimi si formë e bashkëpunimit e përfshinë këtë:

- Dhënia e mjeteve dhe financimi i programeve dhe projekteve të shoqatave të qytetarëve të cilat janë me interes të përgjithshëm ose me interes të qytetit të Sisakut; për këtë qëllim qyteti i Sisakut, me anë të konsultimeve me Këshillin për zhvillimin e shoqërisë civile, do të miratojë vendim për kriteret për caktimin e organizatave qytetare, aktivitete të cilave janë me interes për qytetin e Sisakut. Ky akt do të rregullojë standardet dhe kriteret për caktimin e shoqatave të cilat janë me interes të përgjithshëm për qytetin e Sisakut dhe kushtet që duhet ti plotësojë shoqata që ta realizojë të drejtën e financimit nga buxheti i qytetit;
- Qyteti i Sisakut do të negociojë me shoqërinë civile për dhënie dhe shërbime publike për të cilat ka llogaritur se nuk mundet (tërësisht ose mjaft) që ti ndërmerë përmes organeve të veta.

#### **3.3.3.2. Trupat për bashkëpunim**

Zyra qeveritare për bashkëpunim me shoqatat nuk është e angazhuar vetëm në nivel nacional, por gjithashtu e koordinon punën e trupave administruese në nivel lokal dhe rajonal lidhur me vëzhgimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit me sektorin joqeveritar, jofitimprurës në Republikën e Kroacisë.<sup>62</sup>

<sup>62</sup> Zyra qeveritare për bashkëpunim me shoqatat u themelua me Rregulloren për zyrë qeveritare për bashkëpunim me shoqatat në vitin 1998, me qëllim që të kryejë punë eksperte në fushën e qeverisë kroate lidhur me krijimin e kushteve për bashkëpunim dhe partneritet me sektorin joqeveritar, jofitimprurës, veçanërisht me shoqatat në Republikën e Kroacisë. Informata plotësuese për zyrën mund të gjeni në internet faqen: <http://www.uzuvrh.hr/default-eng.aspx>

Në nivel lokal, nevojitet në mënyrë plotësuese të përmirësohen mekanizmat institucionale për angazhimin e shoqërisë civile. Rreth 40% të njërive të vetëqeverisjes lokale (qytete dhe komuna) kanë një lloj të caktuar të këshillave këshillëdhënëse, ku ka përfaqësues të shoqërisë civile. Për shembull, qyteti i Rjekës e formon Këshillin për zhvillimin e shoqërisë civile, i cili përbëhet nga përfaqësues të vetëqeverisjes lokale dhe OQ dhe është përgjegjës të jap mbështetje në zbatimin e Kartës për bashkëpunim.

Ngjashëm, Karta për bashkëpunim e qytetit të Sisakut e formon Këshillin për zhvillim të shoqërisë civile si trup punues i qytetit të Sisakut dhe shoqatat, të cilat i koordinon aktivitetet e domosdoshme për zbatimin e dispozitave nga Karta. Këshilli është trup i përbërë nga përfaqësues anëtarë të Qytetit të Sisakut dhe shoqatave qytetare.

#### **Kapitulli IV. KËSHILLI PËR ZHVILLIM TË SHOQËRISË CIVILE**

Këshilli për zhvillimin e shoqërisë civile është trup i përbashkët punues i Qytetit të Sisakut dhe shoqatave qytetare të cilat i koordinojnë të gjitha aktivitetet e domosdoshme për aplikimin e dispozitave nga Karta.

Këshillo është trup i përbërë nga 7 anëtarë, prej të cilëve 2 ishin përfaqësues të Qytetit të Sisakut, ndërsa 5 anëtarë përfaqësues të shoqatave qytetare.

Anëtarët i emëron Këshilli i qytetit ashtu që përfaqësuesit e Qytetit të Sisakut propozojnë autoritetet kompetente të Qytetit të Sisakut, ndërsa përfaqësuesit e shoqatave qytetare japin sugjerime për shoqatat të cilat punojnë në qytetin e Sisakut.

Detyrat e Këshillit janë:

- Koordinimi i të gjitha aktiviteteve për aplikimin e dispozitave nga karta dhe inkurajimi i nënshkruesve që ta aplikojnë të njëjtën;
- Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizatat qytetare dhe departamentet e pushtetit të qytetit;
- Dorëzimi i raportit vjetor për punën e vet deri te Këshilli i qytetit të qytetit të Sisakut.

Anëtarët e Këshillit zgjidhen me mandat prej dy viteve.

Kryetarin e Këshillit e zgjedh Këshilli nga radhët e anëtarëve të vet.

Këshilli takohet së paku katër herë në vjet ose sipas nevojës.

Këshilli do të vendos me shumicë votash të anëtarëve të vet.

Anëtarët e Këshillit i kryejnë kompetencat e veta në mënyrë të ndershme dhe nuk marrin kompensim.

#### **3.3.3.3. Financimi**

Financimi nga vetëqeverisjet rajonale dhe lokale është shumë prezent në Kroaci. Në vitin 2009 u shpërndanë 358.625.779,60 kuna dhe kjo është për 9,9% më pak se mjetet e shpërndara në vitin 2008. Pjesa më e madhe e mjeteve i jep qyteti i Zagrebit. 60% të mjeteve shpërndahen për sport, fusha e dytë më e financuar është kultura dhe kultura teknike. Vetëm 2% është shpërndarë për demokraci, vullnetarizëm dhe të drejtat e njeriut. Pranuesit mund të jenë shoqata, rrjete të shoqatave, organizata fetare dhe shoqata joformale të qytetarëve (të paregjistruara).

Në nivel lokal në vitin 2009 u shpërndanë 170.378.869,79 kuna, që është për 22% më pak se në vitin 2008. Pjesën më të madhe të mjeteve e shpërndan qyteti i Rjekës. Këtu ekziston trend i ngjashëm pre dominues që të financohet sporti dhe kultura, përkundër llojeve tjera të aktiviteteve.<sup>63</sup>

Strategjia nacionale thekson se Fondacioni nacional për zhvillimin e shoqërisë civile, përmes pilot programit të filluar për decentralizim të financimit për zhvillimin e shoqërisë civile në nivel lokal dhe rajonal, do ta forcojë

<sup>63</sup> Për më shumë hollësi, shih te: zyra për bashkëpunim me shoqatat dhe raporti për ndihmë financiare të programeve dhe projekteve të organizatave qytetare, 2009.

ndërtimin e mëtejshëm të kapaciteteve të organizatave qytetare në nivel lokal ose rajonal, duke mbajtur llogari edhe për programin ekzistues për mbështetje dhe duke e nxitur vendosjen dhe zhvillimin e programit të ri. Si rezultat i kësaj, Fondacioni nacional shpërndan mjete përmes fondacioneve rajonale.



Një nga shembujt e tillë të shpërndarjes rajonale të mjeteve publike është **Fondacioni për partnerite 92618t dhe zhvillim të shoqërisë civile**, të formuar nga ana e rajonit të Istrës.<sup>64</sup> Fondacioni i Istrës ka partneritet strategjik me Fondacionin nacional.<sup>65</sup> Në pajtim me modelin se decentralizuar për dhënien e ndihmës financiare OQ, Fondacioni shpërndan mjete për iniciativa të bashkësisë nga rajoni i Istrës, rrethi i Primorjes dhe Gorës dhe rrethi i Likës-Senjit.

Fondacioni u themelua në vitin 2006 me qëllim që ta zhvillojë partneritetin dhe shoqërinë civile në rajonin e Istrës. Fondacioni i është kushtuar qytetarëve, OQ, trupave dhe njësisë të autoriteteve lokale në rreth dhe ofron ndihmë ndërkombëtare, profesionale dhe financiare për programe të ndryshme të cilat *inter allia* promovojnë qëndrueshmëri, bashkëpunim, vullnetarizëm dhe filantropi. Qëllimi konkret i Fondacionit është të nxisë pjesëmarrje aktive qytetare në procesin e vendimmarrjes.

Nga vetë fillimi i punës së tij, palët e prekura u inkuadruan që ti caktojnë prioritetet. Pas themelimit të tij, Fondacioni vizitoi 10 qytete në rajonin e Istrës, me qëllim që OQ t'ua prezantojë fushat e veta të zhvillimit dhe krijojë bazë efektive për bashkëpunim të mëtejshëm të suksesshëm. Qëllimi kryesor i vizitave ishte të njoftohen me thirrjet për tenderë dhe të stimulohen OQ të marrin pjesë në punën e Fondacionit. Të gjithë pjesëmarrësit plotësuan pyetësor për vlerësim të nevojave dhe prioriteteve të OQ në rajonin e Istrës, që fondacioni të mund ti caktojë aktivitetet e veta sipas nevojave aktuale. Gjithashtu fondacioni filloi me një aksion “Dyert e hapura për qytetarët”, gjatë të cilës mund ti shpreh problemet dhe nevojat e veta dhe/ose të sugjerojë zgjidhje.

Fondacioni ka këto funksione kryesore:

1. Financiare – kjo përfshinë shpalljen e tenderëve dhe ndihmë organizatave të ndryshme;
2. Informative – ofron informata kryesore për shoqërinë civile dhe funksionin e tij;
3. Arsimore – organizimi i punëtorive, ligjëratave dhe seminareve të ndryshme.

Fondacioni publikon buletin e tij, ruan bazë të dhënave për OQ të cilat punojnë në rajon, gjithashtu është aktiv në nivel rajonal, nacional dhe ndërkombëtar. Aktivitetet e tija caktohen çdo vit në programin për punë që bazohet mbi planet shumëvjeçare strategjike.

<sup>64</sup> Описот на овој модел е земен од интернет-страницата на истарската фондација. За повеќе информации околу работата на фондацијата, нејзините тендери, статусот и управувањето, види: [www.civilnodrustvo-istra.hr/index.php?id=182](http://www.civilnodrustvo-istra.hr/index.php?id=182).

<sup>65</sup> [www.civilnodrustvo-istra.hr/fileadmin/datoteke/Korisni\\_dokumenti/Strategija\\_partnerstva\\_.pdf](http://www.civilnodrustvo-istra.hr/fileadmin/datoteke/Korisni_dokumenti/Strategija_partnerstva_.pdf)



## Fushat për zhvillim të Fondacionit

1. *Mbrojtja e mjedisit jetësor dhe zhvillim i qëndrueshëm*
  - a. Procesi për ngritjen e vetëdijes dhe edukimi për udhëheqje me përgjegjësi me mjedisin jetësor dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
  - b. Mbrojtja e mjedisit jetësor me theks të biodiversitetit dhe nxitjes së organizatave qytetare për mbrojtjen e biodiversitetit.
2. *Demokracia dhe të drejtat e njeriut*
  - a. Mobilizimi i bashkësisë lokale dhe OQ për:
    - zgjidhja e çështjeve lokale sociale, veçanërisht grupeve të marginalizuara;
    - nxitja e dialogut dhe zgjidhjes së qetë të konflikteve;
  - b. Matja e anti korrupsionit;
  - c. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve;
  - ç. Avancimi i të drejtave të njeriut;
  - d. Pakicat;
  - dh. Projekte të mediave jofitimprurëse dhe projekte për medime jofitimprurëse.
3. *Rinia*
  - a. Zhvillimi i politikave ndaj të rinisë;
  - b. Pjesëmarrja aktive e rinisë në vërtetimin e politikave për zhvillim në të gjitha nivelet;
  - c. Ndihmë për arsimim joformal;
  - ç. Kultura dhe menaxhimi me kohën e lirë.
4. *Ndërtimi i kapaciteteve*
  - a. Kapacitete të zhvilluara të Fondacionit;
  - b. Ndihmë për matjen e zhvillimit të kapaciteteve për organizatat qytetare.
5. *Avancimi i sipërmarrjes shoqërore.*

Me Fondacionin udhëheq kryetari dhe këshilli drejtues i përbërë prej katër përfaqësuesve të sektorëve të ndryshëm. Fondacioni financon projekte dhe programe të qytetarëve, shoqatave qytetare në rajonin e Istrës, trupa të pushtetit lokal në rajonin e Istrës. Financimi i programeve vjen nga Fondacioni nacionalë, buxheti i vetëqeverisjes rajonale, buxhetet e trupave të vetëqeverisjes lokale në rajonin e Istrës, donatorë privat (të huaj) dhe sektori korporativ.

Mjetet e Fondacionit shpërndahen në bazë të buxheteve vjetore, të cilat i miraton këshilli në bazë të programit vjetor. Mjetet miratohen në këtë mënyrë:

- ✓ Këshilli shpall tender publik vjetor për financim;
- ✓ Kërkesat i vlerëson Këshilli, i cili i cakton prioritetet;
- ✓ Kriteret dhe metodat për dhënien e mjeteve janë caktuar në Rregulloren për kritere dhe metoda të ndarjes së mjeteve;
- ✓ Marrëveshja për dhënien e mjeteve nënshkruhet me personin që i ka marrë mjetet.

## 3.4. REPUBLIKA E SERBIË<sup>66</sup>

### 3.4.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale në Serbi

Njësitë e vetëqeverisjes lokale në Serbi janë komunat (150), qytetet (23) dhe Qyteti i Beogradit.<sup>67</sup> Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, trupat komunale janë definuar si kuvend komunal, kryetar i komunës, këshilli i komunës dhe administrata komunale. Ata mund të kenë emra të ndryshëm në qytete të ndryshme.

### 3.4.2. Dispozitat ligjore

Të drejtën për pjesëmarrje qytetare në procedurën për miratimin e ligjeve dhe rregullave tjera nuk garantohen në mënyrë eksplicite në **Kushtetutën e Republikës së Serbisë**.<sup>68</sup> Por, kjo del nga të drejtat tjera të garantuara me Kushtetutë, siç është e drejta e mendimit dhe shprehjes të lirë, e drejta e informimit, liria e shoqërimit, e drejta e ankesave, e drejta të propozohen ligje dhe e drejta e referendumit.<sup>69</sup>

Metodat për realizimin e të drejtave të sipërme janë rregulluar me ligje të veçanta. Për shembull, e drejta e informimit janë garantuar me **Ligjin për qasje të pakufizuar deri te informatat me karakter publik**, që u miratua në vitin 2004. Në pajtim me ligjin, informimi me karakter publik paraqet çfarëdo informacioni që e ka trupi i pushtetit publik, e krijuar gjatë punës ose lidhur me punën e trupit të pushtetit lokal, që gjendet në dokument dhe lidhur me çfarëdo qoftë për të cilin opinioni ka interesim të caktuar që të dijë.<sup>70</sup>

**Ligji për vetëqeverisje lokale (2007)**<sup>71</sup> i obligon trupat dhe shërbimet e njësive të vetëqeverisje lokale që ta informojnë opinionin për aktivitetet e veta përmes mjete publike të informimit dhe në mënyrë tjetër adekuate dhe ti sigurojnë të dhënat e nevojshme, sqarimet dhe informatat deri te qytetarët, kur i realizojnë të drejtat dhe obligimet e tyre. Neni 13 (5) rregullon dispozitë të pa obligueshme për bashkëpunim me organizatat qytetare: *“trupat e njësive të vetëqeverisjes lokale mund të bashkëpunojnë me organizata joqeveritare, humanitare dhe organizata tjera me interes të njësisë së vetëqeverisjes lokale dhe banorëve të saj”*.

Sipas Ligjit, eksitojnë tre metoda kryesore të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në punën e vetëqeverisjes lokale: iniciativa qytetare, kuvendi i qytetarëve dhe referendumi. Prej këtyre ne do ti theksojmë iniciativat qytetare dhe kuvendin e qytetarëve.

**Iniciativa qytetare.** Iniciativa qytetare është një lloj peticioni, i cili u jep për të drejtë qytetarëve ti propozojnë kuvendit të vetëqeverisjes lokale të sjellë akt, i cili do ti rregullojë konkretisht çështjet në kompetencë të njësisë së vetëqeverisjes lokale, ndryshimi i statutit ose akte tjera të përgjithshme, ose thirrje për referendum. Ligji e rregullon numrin e minimal të nënshkrimeve të qytetarëve të domosdoshëm për fillimin valid të iniciativës qytetare, që mund të jetë më i vogël se 5% të votuesve (në Inxhi është 15%, Çaçak 5% dhe Beograd 30.000). Por, statutet e njësive mund të rregullojnë numër më të madh. Kuvendi zhvillon diskutim sipas propozimit të iniciativës qytetare dhe dorëzon përgjigje, të mbështetur me argumente deri te qytetarët në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimit të propozimit.

<sup>66</sup> Informatat për këtë pjesë janë grumbulluar nga këto publikime: Dragan Golluboviq dhe Dubravka Velat (2009): Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e përgatitjes dhe aplikimit të ligjeve dhe instrumenteve tjera politike; Oliver Nikoliq et al., Pasqyrë për zbatimin e ligjit për vetëqeverisje lokale në Serbi, 2009; Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në jetën lokale publike, konferencë e përhershme e qyteteve dhe komunave, 2006

<sup>67</sup> Prof. dr. Bogolub Milosavljević, Ph.D., dhe znj. Jelena Jerinid, M.A., Analiza e kompetencave të njësive të vetëqeverisjes lokale në serbi, 2010, [www.drzavnauprava.gov.rs/view\\_file.php?file\\_id=642](http://www.drzavnauprava.gov.rs/view_file.php?file_id=642)

<sup>68</sup> Kushtetuta: [http://www.srbija.gov.rs/cinjenice\\_o\\_srbiji/ustav\\_odredbe.php?id=218](http://www.srbija.gov.rs/cinjenice_o_srbiji/ustav_odredbe.php?id=218)

<sup>69</sup> Nenet 46, 51, 55, 56, 107 dhe 108 nga Kushtetuta

<sup>70</sup> Projekti “Përcjellja e zbatimit të Ligjit për qasje të pakufizuar deri te informatat me interes publik” të Fondit Shoqëria e Hapur, që përfshinë mbi 30 komuna dhe disa trupa republikane, vërtetoi probleme të shumta lidhur me zbatimin e Ligjit. Material plotësues mund të gjendet në: [www.fosserbia.org](http://www.fosserbia.org)

<sup>71</sup> [www.dils.gov.rs/documents/files/maj2010/Zakon%20o%20lokalnim%20samoupravama.pdf](http://www.dils.gov.rs/documents/files/maj2010/Zakon%20o%20lokalnim%20samoupravama.pdf)

**Kuvendi i qytetarëve.** Këto mbledhje konsultative u mundësojnë qytetarëve ti shprehin mendimet e veta për çështje të caktuara me rëndësi lokale, të diskutojnë për nevojat dhe interesat e tyre dhe të japin propozime për çështjet lokale të cilat janë në kompetencë të vetëqeverisjes lokale. Ato mund të thirren me për një pjesë të territorit të komunës ose qytetit të rregulluar me statusin e njësisë. Kërkesat dhe propozimet miratohen me shumicë votash dhe dërgohen deri te Kuvendi ose trupat tjera dhe departamentet e njësive të vetëqeverisjes lokale. Njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet ti shqyrtojnë kërkesat/propozimet, të ndërmarrin qëndrim për kërkesat dhe propozimet e tilla, të hapin diskutim adekuat ose të ndërmarrin masa dhe ti lajmërojnë qytetarët për këtë në afat prej 60 ditëve nga kuvendi i qytetarëve.

Disa nga statutet e njësive të vetëqeverisjes lokale gjithashtu e rregullojnë mundësinë për **marrjen në pyetje publike**. Marrjet në pyetje publike paraqesin metod konsultativ që organizohet në formë të tryezave të rrumbullakëta, dhënin e propozimeve deri te organizatat dhe shërbimet profesionale, shkencore dhe tjera, diskutime në kuvendin e qytetarëve, shpallja e propozim statuteve ose akteve tjera nënligjore të njësive në mediat për informim publik ose në internet faqe, realizimi i anketave për mendimin publik. Nuk ekziston obligim ligjor që vetëqeverisja lokale të miratojë qëndrime dhe ti zbatojë sugjerimet.

Konferenca e përhershme e qyteteve dhe komunave e vlerëson zbatimin e ligjit dhe në vitin 2006 miratoi **rekomandim lidhur me mbështetjen që të rritet pjesëmarrja qytetare në nivel lokal**. Rekomandimi e thekson nevojën nga dhënia e mbështetjes së pjesëmarrjes qytetare në nivel lokal, në mënyrë specifike në Kushtetutë dhe vendosja e më shumë formave në pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në Ligjin për vetëqeverisje lokale. Rekomandimi thekson se statutet dhe rregulloret komunale gjithashtu duhet të përmbajnë kornizë mirë të zhvilluar për pjesëmarrje qytetare.<sup>72</sup>

### 3.4.3. Instrumentet për pjesëmarrje dhe bashkëpunim në nivel lokal

Sipas rekomandimit, disa komuna e bënë hapin e tyre të parë drejt bashkëpunimit me OQ dhe inkuadrimit në procesin e vendimmarrjes (qasja deri te informatat dhe kushtet që i jepen për pjesëmarrje qytetare). U identifikuan rrethanat që vijojnë si pengesë për bashkëpunimin efektiv mes OQ dhe vetëqeverisjes lokale (*inter alia* bazë e pamjaftueshme ligjore e përmendur më sipër):

- ✓ Dominimi i kulturës politike që nuk është afirmative drejt pjesëmarrjes qytetare dhe niveli i ulët i diturisë dhe vetëdijes mes qytetarëve në pikëpamje të drejtave dhe lirive të tyre dhe për kompetencat e niveleve të ndryshme të qeverisë;
- ✓ Mospasja e intersimit qytetar për jetën publike për shkak të kushteve të këqija për jetë, mospasja e kohës, informatave dhe njohurive;
- ✓ Praktikë e pazhvilluar dhe joefektive e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë qytetare;
- ✓ Kornizë jo aq e zhvilluar juridike dhe politike për pjesëmarrje më të madhe qytetare, dhe veçanërisht mospasja e strategjisë së qartë nacionale lidhur me pjesëmarrjen e qytetarëve në nivel lokal dhe obligimeve konkrete të autoriteteve lokale ndaj qytetarëve;
- ✓ Decentralizimi i pamjaftueshëm i pushtetit dhe kapaciteti i vogël financiar i vetëqeverisjeve lokale dhe varësia e tyre e madhe nga trupat e shtetit;
- ✓ Sistem joadekuat lokal zgjedhor, i cili ka efekte të kundërta mbi përfaqësimin e gjithë popullatës në kuvendet lokale;
- ✓ Madhësia e një numri të madh të komunave (në pikëpamje gjeografike dhe sipas numrit të banorëve të tyre), të cilët mesatarisht, janë mes më të mëdhave në Evropë.

<sup>72</sup> Rekomandimi mund të zbritet nga internet faqja: [www.skgo.org](http://www.skgo.org)

### 3.4.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale

Në Beograd për momentin zhvillohen diskutime publike dhe konsultime lidhur me propozim strategjinë për zhvillim të shoqërisë civile. Këtë dokument e inicioi Agjencia për integrim evropian dhe bashkëpunim me shoqatat. Që të mbështetet zhvillimi i strategjisë, kryetari i Beogradit formoi komision ndër sektorial, i cili punon në propozim tekstin dhe do të jetë përgjegjës për zbatimin e saj. Strategjia ka për qëllim të vendos bashkëpunim më të gjerë dhe komunikim të forcuar mes autoriteteve lokale dhe OQ. Komentet rreth propozim tekstit mbledhen mes diskutimeve publike, postës elektronike dhe ueb faqes facebook. Por, përveç këtij shembulli, duket se nuk është praktikë e zakonshme që komunat të nënshkruajnë marrëveshje për bashkëpunim me OQ.

### 3.4.3.2. Trupat për bashkëpunim

Disa komuna kanë trup ose person të caktuar që të bashkëpunojë me OQ. Komuna të shumta kanë formuar departament për marrëdhënie me opinionin, me detyrë që të punojnë në përmirësimin e informimit dhe komunikimit me opinionin, duke përfshirë edhe OQ, në pajtim me rekomandimin. Edhe krahas asaj se nuk ka asnjë model ose trup që punon vetëm në zhvillimin e sektorit në tërësi, janë vendosur modele të ndryshme që ta avancojnë bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen mes vetëqeverisjes lokale dhe OQ në fusha dhe aktivitete të caktuara (p.sh. zvogëlimi i varfërisë, pengesa në zhvillim, rinia). Shumica prej tyre u vendosën si pjesë e projekteve të përgjithshme dhe ka shumë pak informata për suksesin e zbatimit dhe funksionimit të tyre. Edhe krahas kësaj, këto modele mund të merren parasysh gjatë diskutimeve për qasjen e caktuar në shtet tjetër.

#### ✓ Qendra për shoqëri civile, Beogradi i ri

Komuna Beogradi i ri vitin e kaluar e themeloi Qendrën për shoqëri civile<sup>73</sup>. Qëllimi i tij është të ofrojë ndihmë institucionale OQ-ve, përmes sigurimit të hapësirës për punë, zyra, ndihmë administrative dhe teknike. Qendra e ofron hapësirën e vet që për kompensim të caktuar, që pastaj e shfrytëzon për aktivitetet e veta për mbështetje të punës së OQ. OQ mund ti shfrytëzojnë ofertat e Qendrës në bazë të kërkesës së dorëzuar për partneritet me qendrën. Këshilli i Qendrës është trup i cili vendos për çdo kërkesë.

#### ✓ Këshilli për çështje lidhur me personat me pengesa në zhvillim të qytetit të Kragujevcit<sup>74</sup>

Këshilli për çështje lidhur me personat me pengesa në zhvillim u themelua në Kragujevc më 13 mars 2009, me iniciativë të Forumit për të rinj me pengesa në zhvillim. Nevoja për themelimin e Këshillit ishte për shkak të inkuadrimit të pamjaftueshëm të personave me pengesa në zhvillim në zgjidhjen e çështjeve me rëndësi për statusin e tyre, si dhe mungesa e mekanizmit institucional për bashkëpunim mes përfaqësuesve të institucioneve të vetëqeverisjes lokale dhe organizatave të personave me pengesa në zhvillim. Këshilli është trup punues i kuvendit komunal. Ai është i përbërë prej 12 personave të cilët përfaqësojnë sektorë të ndryshëm (vetëqeverisje lokale, OQ, institucione, ekspertë). Detyrat e Këshillit janë:

- Mban bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet dhe shoqatat e personave me pengesa në zhvillim, që të vërtetohen nevojat prioritare dhe të zgjidhen problemet aktuale të invaliditetit;
- Kontribuon për përmirësimin e kualitetit të jetës së personave me pengesa në zhvillim përmes bashkëpunimit aktiv ndër sektorial në zgjidhjen e çështjeve sociale, shëndetësore, arsimore, kulturore dhe çështje tjera;
- Përpiqet të kontribuojë në rritjen e nivelit të ndjeshmërisë për nevojat komunale dhe ka të bëjë me personat me pengesa në zhvillim;
- Vendosja e bashkëpunimit me institucionet adekuate në qytetet dhe komunat tjera me qëllim të formohen pikëpamje paralele për gjendjen e personave me pengesa në zhvillim në fushën e mbrojtjes sociale;
- Kryen obligime dhe detyra tjera në pajtim me strategjinë për zhvillim të mbrojtjes sociale në qytet.

<sup>73</sup> <http://www.novibeograd.rs/?jez=&p=51&v=4643>

<sup>74</sup> <http://www.kragujevac.rs/274-1-l>

- Në mbledhjen e parë të mbajtur më 4 mars 2011 Këshilli e miratoi Rregulloren për punë dhe planin strategjik.

### ✓ **Këshilli dhe zyra për zhvillim të bashkësisë, Lloznicë**

Këshilli dhe zyra për zhvillim të bashkësisë në Lloznicë është një nga këshillat e themeluar si pjesë të programit “Mbështetja për forcimin e pjesëmarrjes qytetare në Serbi”, e zbatuar bashkërisht nga ana e pushtetit lokal, Konferenca e përhershme e qyteteve dhe komunave dhe Agjencia zvicerane për bashkëpunim dhe zhvillim<sup>75</sup>. Krahas kësaj, vetëqeverisja lokale e vendosi Zyrën dhe siguroi zyra dhe mjete për një të punësuar, derisa donatorët siguruan mjete edhe për një të punësuar dhe pajisje për zyrë. Zyra jep mbështetje në këshilla dhe është paraparë të jetë “dritare e institucionalizuar drejt shoqërisë civile” në kuadër të vetëqeverisjes lokale, që është përgjegjëse ta avancojë dialogun dhe bashkëpunimin. Programi ka për qëllim ti zhvillojë kapacitetet e zyrës dhe personelit për zbatimin e projekteve, të cilat kanë të bëjnë me bashkësinë dhe të angazhojë dhe të konsultohet me qytetarët gjatë procesit. Si pjesë e programit dhe komponentit për zhvillimin e kapaciteteve, roli i Këshillit ishte të zgjedhë tema për projekt konkret. Këshilli ishte përgjegjës që të konsultohet me qytetarët për temën dhe ta zbatojë projektin, duke siguruar mikro mjete të pakthyeshme për organizatat tjera dhe mbikëqyrje të këtyre mjeteve të pakthyeshme.

### ✓ **Komiteti komunal për koordinim të politikës sociale (KKKPS)<sup>76</sup>**

KKKPS u paraqit si një nga komponentët e projektit “Reforma të politikës sociale” dhe u themelua në disa komuna në gjithë Serbinë. Komiteti është trup këshillëdhënës i kryetarit të komunës, që është formuar në pajtim me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Komiteti bashkëpunon me shërbimin për aktivitete sociale në vetëqeverisjen lokale dhe në kuvendin komunal. Komiteti përbëhet nga përfaqësues nga të gjitha institucionet adekuate të vetëqeverisjes lokale, shkollat, institucionet sociale dhe përfaqësues të OQ. Kriteret kryesore për zgjedhje të anëtarëve të Komitetit janë: gatishmëria dhe motivimi për pjesëmarrje në procesin e reformave të mbrojtjes sociale; ekspertiza; njohja e problemeve lidhur me nevojat e grupe në nevojë; respekti në komunë; gatishmëria për punë ekipore. Komiteti është përgjegjës për këto aktivitete: formulimi i planit strategjik që do të zgjidhte problemet e shumicës së grupeve në nevojë në komunë (të cilave i paraprin dizajnimi i planeve aksionare, analiza e gjendjes, nevojave dhe resurseve ekzistuese); avancimi i partneritetit; propozimi i masave parandaluese në fushën e mbrojtjes shëndetësore, mbrojtjes sociale, punësimi dhe arsimimi; marrja parasysh e modaliteteve për aktivitete financiare në fushën e politikës sociale dhe vëzhgimi i metodave për shfrytëzimin e këtyre mjeteve; prezantimi i aktiviteteve dhe rezultateve të KKKPS, përgatitja e iniciativave dhe propozimeve me thirrje të procesit decentralizmit dhe politikës sociale, kushtet të cilat lejojnë organizimin e konferencave tematike dhe tubimeve tjera profesionale. Anëtarët e Komitetit i kryejnë aktivitetet në bazë vullnetare.

#### **3.4.3.3. Financimi**

Sipas vlerësimit të Indeksit për qëndrueshmëri të USAID 2009, resurset që i sigurojnë agjencitë e pushtetit lokal zakonisht janë minimale.

<sup>75</sup> [http://www.loznica.rs/OPSTINA-LOZNICA-Kancelarija-za-razvoj-zajednice\\_256\\_\\_\\_lat](http://www.loznica.rs/OPSTINA-LOZNICA-Kancelarija-za-razvoj-zajednice_256___lat)  
Këshilla tjera të ngjashme u formuan në Valevë, Sremski Karlovac, Krupanj, Osečina dhe Çoka.

<sup>76</sup> Siç është përshkruar në Dragan Golubović dhe Dubravka Velat (2009): Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e përgatitjes dhe aplikimi i ligjeve dhe instrumentet tjera publike politike.

## 3.5. ANGLIA

### 3.5.1. Pasqyrë e përgjithshme e vetëqeverisjeve lokale ne Angli

Anglia është e ndarë në nëntë regjione. Niveli nën-regjional dhe duke mos e përfshirë Londrën, Anglia ka dy lloje të ndryshme të pushtetit lokal. Në disa rajone ka këshill qarkor përgjegjës për shërbime, siç janë arsimi, menaxhimi me mbeturina dhe planifikimi strategjik në kuadër të qarkut, me disa këshille rajonale përgjegjës për shërbime, siç janë strehimi, mbledhja e mbeturinave dhe planifikimi lokal. Disa rajone kanë vetëm një nivel të pushtetit lokal dhe ato quhen pushtete unitare.

### 3.5.2. Dispozitat ligjore

Dispozitat për dhënien e informatave të cilat i posedojnë pushtetet publike – duke i përfshirë edhe vetëqeverisjet lokale dhe persona të cilët për ato sigurojnë shërbime janë përcaktuar me **Aktin për liri të informimit 2000**<sup>77</sup>. Ai i thekson të drejtat e përgjithshme të qasjes deri te informata të cilat i posedojnë pushtetet publike, sipas të cilave secili person i cili parashtrohet për informata deri te pushteti ka të drejtë:

- Të informohet me shkrim nga ana e pushtetit se a e posedon atë informatë publike nga përshkrimi i dhënë në kërkesë;
- 6) Nëse po, ato informata duhet ti jepen personit.

Pushteti duhet të përgjigjet në afat prej 12 ditësh, pos nëse kërkesa nuk është problematike. Pushteti mundet ta informon parashtruesin e kërkesës me shkrim për shumën të cilën duhet ta paguan për ta siguruar informatën. Në rast se kërkesa refuzohet, pushteti po ashtu do ta informon palën për këtë fakt, duke e cekur përjashtimin për të cilin bëhet fjalë dhe shpjegon pse përjashtimi zbatohet.

Pushteti do të përpilojë plan për publikim i cili duhet të miratohet nga ana e komisarit për mbrojtjen e të dhënave. Pushteti publik do të shpall informatat në pajtim me planet e tyre për publikim.

Sekretari shtetërorë shpall kodeks të praktikës i cili përfshin informata për pushtetin publik nga aspekti i praktikës e cila, sipas mendimit të tij, do të jetë mirë ata ta ndjekin.

Nëse komisari mendon se praktika e pushtetit publik nuk është në pajtim me kodeksin e praktikës, ai mundet pushtetit ti jep rekomandim që ti caktojë hapat që duhet të ndërmerren për përmirësimin e asaj praktike.

**Akti për demokraci lokale, zhvillim ekonomik dhe ndërtim 2009** përfshin dispozita për qëllimet e përmirësimit të kyçjes së opinionit nga aspekti i pushteteve lokale dhe pushteteve tjera publike.<sup>78</sup>

Sipas këtij Akti, pushtetet lokale – duke i përfshirë edhe këshillat qarkorë apo rajonal në Angli, këshilli i një pjese të Londrës dhe këshilli i përbashkët i Qytetit të Londrës, kanë obligim ta përmirësojnë kuptimin mes njerëzve për gjërat në vijim:

- 1) funksionet e pushteti;
- 2) aranzhimet demokratike<sup>79</sup> të pushtetit;
- 3) si anëtarët e opinionit mundet të marrin pjesë në këto aranzhime demokratike dhe çka përfshinë pjesëmarrja (më saktë si të bëhen pjesë e pushtetit kryesor lokal, çka bëjnë anëtarët e pushtetit lokal themelor, çfarë ndihme kanë në dispozicion anëtarët e pushtetit lokal).

<sup>77</sup> Krejt tekstin e Aktit mundeni ta lexoni në internet faqen në vijim:  
[http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2000/36/pdfs/ukpga\\_20000036\\_en.pdf](http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2000/36/pdfs/ukpga_20000036_en.pdf)

<sup>78</sup> Tërë tekstin e Aktit mundet ta lexoni në internet faqen në vijim:  
[http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2009/20/pdfs/ukpga\\_20090020\\_en.pdf](http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2009/20/pdfs/ukpga_20090020_en.pdf)

<sup>79</sup> Aranzhmanet demokratike donë të thotë aranzhmanet për anëtarët të opinionit të marin pjesë apo të ndikojnë në sjelljen e vendimeve të pushteteve

Pushteti nacional mundet të jep rekomandim për pushtetet lokale për kryerjen e përgjegjësi të tyre. Rekomandimi mundet të jetë gjeneral apo për një apo më tepër pushtete lokale, mundet të dallon për pushtete të ndryshme lokale kryesore dhe duhet të shpallet.

Akti i përcakton rregullat për zgjidhjen e peticioneve të dorëzuara deri te pushtetet lokale. Një pushtet kryesor lokal duhet të siguron që peticionet të jepen në formë elektronike deri te pushteti dhe do të përgatis dhe shpall plan për peticion në internet faqen e vet apo në mënyrë të cilën pushteti e mendon adekuat. Pushteti duhet patjetër të dërgon vërtetim me shkrim për peticionin deri te organizatori i peticionit në kuadër të periudhës së caktuar. Në vërtetim duhet patjetër të jepen informata për atë se çka ka bërë apo çka propozon pushteti të bëjë si përgjigje të peticionit.


**Akti për vetëqeverisje lokale 2003** nuk përkushton pjesë të veçantë për pjesëmarrje qytetare në sjelljen e vendimeve, por në tema të veçanta tregon me cilën duhet qytetari të konsultohet para se të sjell vendim (për shembull *“cilët do qoftë persona tjerë të cilët sipas tij duket se i përfaqësojnë interesat për të cilët ekziston mundësia se janë goditur”*)<sup>80</sup>.

### 3.5.3. Instrumentet për pjesëmarrje dhe bashkëpunimi në nivel lokal

Në vitin 2007 Komisioni për integrim dhe kohezion në mënyrë eksplicite tregoi se banorët të cilët besojnë se mundet të ndikojnë në vendimet lokale me siguri u besojnë pushteteve lokale 30%.<sup>81</sup>

Anglia ka spektër të gjerë të praktikës dhe vegla të shumta (programe<sup>82</sup>, doracak<sup>83</sup>, kontrata, plane për implementim<sup>84</sup>) për ta artikuluar nevojën për kyçje të sektorit civil në procesin e sjelljes së vendimeve në mënyrë të barabartë si në nivel nacional ashtu edhe në lokal. Para së gjithash, vetëqeverisjet lokale kanë praktikë të gjatë të miratimit të marrëveshjeve lokale si mjet për ndërtimin e kuptimit dhe besimit të ndërsjellë.

Përdoren metodat konkrete në vijim të pjesëmarrjes për kyçje të bashkësive në sjelljen lokale të vendimeve:



*Burim: Pjesëmarrje: tendenca, fakte dhe numra, Al-manak: NCVO, mars 2011.*

<sup>80</sup> Tërë tekstin e Aktit mundet ta gjeni në internet faqen në vijim: [http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2003/26/pdfs/ukpga\\_20030026\\_en.pdf](http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2003/26/pdfs/ukpga_20030026_en.pdf)

<sup>81</sup> Informatat u cituan nga internet faqja në vijim: <http://www.peopleandparticipation.net/pages/viewpage.action?pageId=26707077>

<sup>82</sup> Projekti për përmirësimin e partneritetit lokal, Programi për përmirësimin e partneritetit

<sup>83</sup> Doracak për zbatimin e marrëveshjes lokale të shpallur nga ana e NCVO

<sup>84</sup> Bashkësi të forta dhe përparimtare – Libri i bardhë i pushtetit lokal (plani për zbatim final) i shpallur nga ana e Departamentit për bashkësi dhe pushtet lokal

Interneti luan rol gjithnjë e më të rëndësishëm në kyçjen e opinionit në procesin e sjelljes së vendimeve. Madje edhe ato të cilët nuk mundën personalisht të marrin pjesë në takimet e këshillit dhe në forume tjera, mundën t'i ndjekin ngjarjet ose duke luajtur menjëherë apo duke i incizuar dhe do të luajnë kur të duan. Interneti ndarja është gjithashtu interaktive dhe shfrytëzuesit mundet të dërgojnë komente dhe pyetje nëpërmjet një test-vegle nëpërmjet së cilës mundën të marrin përgjigje menjëherë.

Një nga shembujt është **Harigari drejtpërdrejtë në korrik 2007. Kjo është një rrjetë e udhëhequr nga qytetarë ku fitohet shpërblim i dyfishtë dhe ka 4.000 shfrytëzues të regjistruar. Në vitin 2008 u regjistruan rezultate në vijim:**

- ✓ Pas një viti pune, interneti faqja ka pothuaj 1000 anëtarë, të cilët paraqesin rreth 5% e popullatës. Ky numër rritet vazhdimisht nga java në javë;
- ✓ Çdo ditë ueb faqja ka mbi 200 vizita prej mbi 100 personave të ndryshme;
- ✓ Ueb faqja jep rishikim të banorëve me prioritet të cilët kanë marrë përgjigje prej 70%. Kjo dorëzohet deri te pushteti lokal së bashku me rezultatet e planit dhe kjo të përdoret si bazë për kartën lokale;
- ✓ Ueb faqja ka realizuar fushata në lidhje me çështje të komunikacionit për organizimin e peticionit drejtpërdrejtë. Peticioni ka qenë aq i suksesshëm sa që pushteti lokal i ka rishikuar planet;
- ✓ Anëtarët e ueb faqes mësojnë për informata të reja dhe aftësi të reja për at se si në mënyrë të drejtpërdrejtë të kyçen në çështje për të cilat mendojnë se janë të rëndësishme. Policia lokale në mënyrë aktive kontribuon për ueb faqen;
- ✓ Ueb faqja tani më ka kërkuar të ndërtohet elementi për tu lidhur me qytetin tjetër fqinj dhe inicicion lidhje mes grupeve heterogjene në rajon;
- ✓ Anëtarët raportojnë se kanë dobi të madhe për shkak të aftësisë së ueb faqes tu mundëson anëtarëve që mes veti të japin përkrahje praktike dhe motive nga aspekti i problemeve dhe pengesave;
- ✓ Me atë se punon drejtpërdrejtë ueb faqja mundëson të zhvillohen miqësi të shumta të reja dhe lidhje me fqinjët;
- ✓ Në vitin 2008 ueb faqja i koordinon anëtarët ta organizojnë festimin më të madh veror në lagje.<sup>85</sup>

### 3.5.3.1. Dokumentet politike dhe strategjitë lokale

#### Marrëveshja nacionale

**Marrëveshja** – marrëveshja mes qeverisë dhe sektorit të tretë filloi në vitin 1998 në nivel nacional dhe mendohej të jetë një instrument i cili do të nxjerr një sërë çështjesh nga margjinat e politikës qeveritare dhe të bëhen praktikë e prituri (për shembull tre vite financim, tre muaj periudha këshillëdhënëse). Edhe pos asaj se i përket nivelit nacional, qeveria gjithashtu e artikulon qëllimin e saj “*në mënyrë aktive ta inkurajon zgjerimin e saj... të qeverisë lokale, e cila do të ftohet të miraton marrëveshje e cila do të përgjigjet marrëdhëniet e tyre me sektorin vullnetar apo komunal*”.

Në bazë të përvojave, marrëveshja e re nacionale u miratua në dhjetor të vitit 2009. Sipas propozim marrëveshjes të cilën e dha Simon Blek, Marrëveshja nacionale duhet të siguron kornizë për inicimin e aksionit të marrëveshjes lokale, me çka do të sigurohen marrëdhënie produktive në gjitha nivelet.

Në Marrëveshje janë përcaktuar parimet e përbashkëta si kornizë për marrëveshje lokale: respektim, pavarësi, llojllojshmëri, barazi, dhënie pushtet qytetarëve, vullnetarizëm.<sup>86</sup>

<sup>85</sup> <http://www.peopleandparticipation.net/pages/viewpage.action?pagelid=26707077> dhe <http://www.harringayonline.com/>

<sup>86</sup> Marrëveshja për marrëdhëniet me Qeverisë dhe Sektorit të Tretë në Angli.



## Marrëveshja lokale dhe aktivitetet të cilat e përkrahin implementimin

100 % e rajoneve lokale në Angli janë të përkushtuar për funksionim më të mirë të partneriteteve mes vetëqeverisjes lokale, organeve publike lokale dhe organizatave lokale vullnetare dhe organizatave të bashkësive nëpërmjet **marrëveshjeve lokale**. Marrëveshjet lokale janë dokumente të gjalla të cilët informojnë për spektër të gjerë të punës së përbashkët në nivel lokal, duke filluar nga policia e cila punon me sektorin e bashkësisë për zgjidhjen e sjelljes anti-sociale, e deri te shërbimet sociale të cilat e përmirësojnë kontaktimin me organizatat për kujdes social.

Dobia e të pasurit marrëveshje lokale për sektorin e tretë është përmbledhur në vijim: (1) Dobi për bashkësinë (zhvillimi i shërbimeve në bazë të nevojave të bashkësisë); (2) Realizimi i qëllimeve organizative (përmirësimi i kauzës së organizatës); (3) Përmirësimi i marrëdhënieve të partneritetit (bashkëpunim i ngushtë me pushtetet lokale); (4) Përdorimi i mjeteve të jashtme në mënyrë më efektive; (5) Kycja e grupeve lokale si vlerë më e mirë dhe planifikim në bashkësi.<sup>87</sup>

Internet faqja për Marrëveshjen ishte shumë burim i dobishëm prej ku rajonet mundeshin ti marrin marrëveshjet lokale.<sup>88</sup>

Pa marrë parasysh popullaritetin e marrëveshjeve, kishte nevojë të përmirësohet implementimi i këtyre dokumenteve. Si përkrahje për këtë, Këshilli nacional për organizata vullnetare përpiloi një **“doracak për implementimin e marrëveshjes lokale”**, udhërrëfyes gjithëpërfshirës dhe i dobishëm i cili do të bëjë që marrëveshjet lokale të funksionojnë në praktikë. Më saktë, informata dhe këshillat janë drejtuar drejt asaj që mundet të arrihet me Marrëveshjen dhe ofrojnë disa mënyra për “zbulimin e problemeve” për të ndihmuar në diagnostifikimin dhe zgjidhjen e punëve që nuk funksionojnë.

Doracku për implementimin e marrëveshjes lokale i thekson angazhimet për konsultime të marrëveshjes lokale:

Këshilli i **Liverpulit** angazhohet për tu konsultuar me sektorin që nga faza e zhvillimit.

Marrëveshja me **Barnet** angazhohet që grupet të konsultohen me organet publike nga aspekti i ndryshimeve të cilat mundet të ndikojnë në shërbimet e tyre.;

**Northemtonshir:** konsultime për barazi mes grupeve të financuara dhe jo të financuara;

**Kraven:** tu lehtësohet grupeve të reja të shprehen lirshëm gjatë konsultimeve;

**Ealing:** koordinimi i konsultimeve dhe komunikimit mes departamenteve për ta hequr barrën nga grupet lokale.

**Bakingemshir:** Plani aksionar apo Marrëveshja përfshinë përpilimin e kalendarit për konsultime;

**Ashford:** Vlerësimi i konsultimeve së bashku me qëllim që të zhvillohet dhe të përhapet praktika më e mirë.

**Marrëveshja lokale nga Bakingemshir** ka rregulla mjaft të hollësishme, të cilat kanë të bëjnë me procesin e konsultimeve, i cili meriton të zbatohet në tërësi:<sup>89</sup>

<sup>87</sup> H Nilda Bullen dhe Radost Tofrisova (2004): *Analizë gjithëpërfshirëse për politikat evropiane dhe praktika të OJQ-ve*. Bashkëpunim qeveritar. ECNZ, Budapest.

<sup>88</sup> Komisioni për Marrëveshjen u ndal së punuari më 31 mars 2011, megjithatë burimet e informatave akoma janë në dispozicion në internet faqen e arkivës së Qeverisë së Britanisë së Madhe

<sup>89</sup> Tërë tekstin e Marrëveshjes lokale Bakingemshir mundeni ta gjeni në internet faqen në vijim: [http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20110314111751/http://www.thecompact.org.uk/shared\\_asp\\_files/GFS.R.asp?NodeID=100475](http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20110314111751/http://www.thecompact.org.uk/shared_asp_files/GFS.R.asp?NodeID=100475)

## **Konsultim**

Dy sektorët pranojnë se konsultimi është një proces dykahësor mbi të cilin në të shumtën e rasteve ndikon qeveria. Dy sektorët pajtohen të punojnë si në vijim:

- Koordinim, zhvillim dhe përmirësim të metodave aktuale për konsultim për të siguruar që ata ti kycin të gjithë;
- Qasje deri te iniciativa adekuate të reja, materiale për konsultime, politika dhe veprime;
- Shqyrtim i domethënies së kyçje të përfaqësuesve të njëjtë në konsultime dhe partneritete dhe përfaqësuesit të kenë autorizime adekuate.

- Nga të dy sektorët bashkërisht do të zhvillohet doracak për praktikë të mirë si përkrahje të kësaj pune.

## **Korniza kohore të konsultimeve**

Si edhe shumica e komiteteve për menaxhim në sektorin vullnetar, këto takohen në çdo dy deri tre muaj, sektori statutar do të ketë për qëllim ti ndjekë rekomandimet e Qeverisë për tu mundësuar 12 javë për konsultime të shkruara. Por të dy sektorët i pranojnë kufizimet kohore në të cilat punojnë dhe në qoftë se janë të domosdoshme korniza më të shkurta kohore, ata do ti kenë parasysh metoda alternative dhe qasje me qëllim që të sigurojnë që konsultimet të mbahen me kualitet të mirë dhe të jenë efektive.

Të dy sektorët do të synojnë drejt koordinimit të kohës për konsultime dhe atje ku mundet do ti ndajnë resurset për të ndihmuar në zvogëlimin e numrit të konsultimeve.

## **Konsultim qeveritar**

Të dy sektorët u morën vesh që të bëjnë si në vijim:

- Të informohet mes veti për konsultimet e ardhshme me pushtetin qendror;
- Të zbatojnë qëndrime dhe ti koordinojnë atje ku janë të dobishme të jepet qëndrimi apo mendimi;
- Të punojnë së bashku për ta inkurajuar Qeverinë në kohë të raporton për kornizat kohore për konsultime dhe për korniza kohore reale.

## **Informim për konsultim**

- Të dy sektorët u morën vesh të bëjnë si në vijim:
- Të sqarohet në lidhje me çka është konsultimi dhe qëndrimet e kujt kërkohen;
- Të sqarohet pse e kanë zgjedhur metodën e dhënë e cila do të përdoret në konsultime;
- Atje ku mundet, të jepet sqarim i shkurtë për konsultimin dhe të tregohet a është në dispozicion versioni i plotë;
- Të përdoret gjuhë e thjeshtë pa fjalë të panevojshme apo nëse ajo nuk është e mundshme të sqarohen terminët e veçanta;
- Të sqarohet si dhe kurë do të përdoret informata e marrë gjatë konsultimeve;
- Tu jepen informata atyre të cilët kanë marrë pjesë në konsultime dhe rezultatet për të njëjtën;
- Të jepen në dispozicion dokumentet për konsultimet në formate të ndryshme atje ku është e mundshme;
- Të jepet përgjigje e përbashkët atje ku është e mundshme.

Sektori statutar do të bëjë si në vijim:

Të bëjë qartë me dije kur konsultimi mundet të sjellë deri në ndryshim;

Të ceket sa faza do të ketë konsultimi dhe kush do të konsultohet;

Të bëjë qartë me dije pse një grup i caktuar vullnetar apo grup i bashkësisë është konsultuar për çështje të caktuara (për shembull, si dhënës i shërbimit, si përfaqësues i bashkësisë apo vullnetarë, si përfaqësues i BCS-s, si organizatë për menaxhimin e fushatës, etj).

BCS do të bëjë si në vijim:

- Do të siguron dhe do të shpall informata për konsultime atje ku ka nevojë;
- Do ta përdorë rrjetin e vet të organizatave të inkurajon dhe të përkrah pjesëmarrje aktive në konsultime;
- Të bëjë qartë me dije se a përgjigjet ai si dhënës i shërbimit, përfaqësues i bashkësisë apo vullnetarëve, shfrytëzues i shërbimit apo organizatës për menaxhimin me fushatën;
- Të bëjë qartë me dije se a bazohen përgjigjet e tyre në konsultime me anëtarët apo përvojën e tyre personale apo diturinë.

Në vitin 2008 Instituti për hulumtime të aksioneve vullnetare përgatiti një projekt raport **“Çka e bën të suksesshëm një marrëveshje lokale”**<sup>90</sup>, në të cilin u identifikuan faktorët dhe praktikat e mira të cilat kontribuojnë për zbatim më efikas të marrëveshjeve lokale

Faktorë kyç për sukses të marrëveshjeve lokale janë si në vijim:

<b>Faktor i rëndësishëm për sukses</b>	<b>Si të arrihet ajo</b>
<b>Drejtuar kah rezultatet</b>	Shërbime më të mira Përmirësime praktike
<b>Vendosja e strukturës dhe lidhjeve të vërteta</b>	Lidhje me LSP <sup>91</sup> dhe LAA Rrënjëzim në pagesa dhe furnizime
<b>Udhëheqje të Marrëveshjes</b>	Udhëheqje e shkëlqyer Resurse dhe përkrahje për kampionët
<b>Kyçje të palëve të prekura</b>	Kyçje shumësektoriale Anëtarë të zgjedhur Drejtori për shërbime
<b>Të jetë sektor i tretë efektiv</b>	Përdorimi i strukturave të vendosura Kyçje të sektorit të tretë më të gjerë
<b>Divestim i Marrëveshjes</b>	Punëtor të përkushtuar Rrënjëzim të Marrëveshjes në role të shumta
<b>Marrëveshja të jetë reale</b>	Vegla praktike Informata të qasshme Kyçje të personalit Kyçje të sukseseve të Marrëveshjes
<b>Marrëveshja të funksionon në lëmi dyshtresore</b>	Mekanizma për kontrollë Grupe pune me përfaqësimit nga të gjitha shtresat Zgjidhje të dallimeve lokale Konsultim i vazhdueshëm

Revidimi i rregullt i marrëveshjeve lokale është e rëndësishme me qëllim që të vlerësohet suksesi i zbatimit të tyre – çka ka funksionuar mirë dhe çka duhet akoma të bëhet. Në Saseksun Lindor, grupi përdorte anketë të cilën e përpiloi NCVO<sup>92</sup> e cila pastaj dërgohej te njerëzit dhe deri te sektori publik dhe qytetar. Grupi i Marrëveshjes i vlerësoi marrëveshjet, i tregoi rezultatet dhe LSP-s i propozoi aksione që duhet të ndërmerren.

<sup>90</sup> Tekstin mundeni ta gjeni në internet faqen në vijim:

<http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20110314111751/http://thecompact.org.uk/files/102330/FileName/WhatmakesasuccessfulLocalCompact-Report.pdf>

<sup>91</sup> Partneritet lokal strategjik

<sup>92</sup> Këshilli Nacional për organizata vullnetare

Organizata tjera, siç është **Zëri i Marrëveshjes**<sup>93</sup>, gjithashtu u angazhuan ta theksojnë rëndësinë e një partneriteti mes OJQ-ve dhe pushtetit. Ai kohëve të fundit shpalli portfolio të studimeve të shkurta me çka e treguan zbatimin praktik të marrëveshjeve lokale të quajtur “*Marrëveshje lokale të punës*”<sup>94</sup>.

### 3.5.3.2. Trupat për bashkëpunim

Si pranim të rëndësishme të marrëveshjeve lokale të disa pushteteve, siç është rasti me Islington, ekziston **punëtor i përkushtuar Marrëveshjes**. Partnerët lokal pajtohen se punëtori i përkushtuar marrëveshjes si “fytyrë markante e Marrëveshjes” do të ketë përparësi ashtu që do të punon pa pasur konflikt interesash. Duke e falënderuar punës së punëtorit të përkushtuar Marrëveshjes, Islington ishte në gjendje të organizon tre ngjarje me qindra pjesëmarrës nga të dy sektorët për ti festuar sukseset e Marrëveshjes Lokale.

Gjithashtu rregullisht formohet **grup menaxhues i Marrëveshjes** për ta mbikëqyrur implementimin e marrëveshjeve lokale, siç është rasti me Calderdale dhe Hetvordshir. Këto janë grupe shumë-sektoriale, duke i përfshirë edhe përfaqësuesit e sektorit të tretë, këshillit, lidhjes për kujdes primar, odat lokale ekonomike.

Në disa raste siç është në Levisham, ekziston edhe përfaqësuesi i Marrëveshjes dhe grup menaxhues i Marrëveshjes për të siguruar që të tejkalohet dallimi i cili ndonjëherë ekziston mes dy palëve.

Ekzistojnë edhe forma tjera të zhvilluara të përfaqësimit të interesave të sektorit të tretë në procesin e sjelljes së vendimeve. Në Birmingham ekziston **anëtarë në kabinet** i cili i menaxhon marrëdhëniet në sektorin e tretë dhe siguron që sektori i tretë të ketë qasje deri te kabineti i Këshillit (për shembull në rolin e nikoqirit në pranime për liderë të sektorit të tretë lokal).<sup>95</sup>

Qarku i Devonit është shembull i mirë për përfaqësimin në pushtetin dyshtresorë. Qarku dhe 9-to rajonet kanë LSP-ja të veta dhe çdo LSP delegon nga një person nga sektori qytetar dhe sektori publik në **Qendrën e marrëveshjes në nivel të vendit**. Roli i pjesëmarrësve në Qendrën e marrëveshjes është të inicion çështje strategjike nga fushat e veta dhe të kthehen në nën-rajonet e veta si ambasadorë për marrëveshjen për Devon.<sup>96</sup>

### 3.5.3.3. Financimi

**Marrëveshja lokale e punës** e thekson shembullin e **qytetit Merton** se në gjendjen e tanishme ekonomike kritike kycja e OQ në procesin e sjelljes së vendimeve është e një rëndësie të madhe.

Bisedimet mes sektorëve për atë si ri përgjigjet recesionit filluan në vitin 2008. Në korrik të vitit 2010 Këshilli filloi të konsultohet me OJQ-t për atë se si të lehtësohet ndikimi i zvogëlimeve të planifikuara. Këto biseda ndihmuan të përcaktohen aktivitetet për të dy palët dhe sektori vullnetar dhe sektori i bashkësive ishin në gjendje ta bëjnë fillimin kryesor për tu bërë kursime efikase nëpërmjet bashkëpunimit dhe rrjetëzimit. Në këtë mënyrë ata ishin në gjendje ta zbusin ndikimin duke i zvogëluar mjetet për vitin 2009/2010 për 10%. Që atëherë pushteti lokal vendosi ta mbajë shumën e financimit në nivel të njëjtë në vitin 2010/2011 si pranim të faktit se mjetet e pakthyeshme mundet të sigurojnë vlerë të shkëlqyer për paratë. Por, edhe pos zvogëlimit, Këshilli jo vetë që i ruajti marrëdhëniet e mira me sektorin vullnetar dhe sektorin e bashkësisë por edhe e fitoi besimin dhe e përmirësoi bashkëpunimin.

<sup>93</sup> Zëri i Marrëveshjes është rrjetë e përbërë nga mi 2.300 anëtarë e cila jep këshilla dhe trajnim për marrëveshjen dhe i përfaqëson interesat e sektorit

<sup>94</sup> Tekstin mundet ta gjeni këtu:

[http://www.compactvoice.org.uk/sites/default/files/local\\_compacts\\_at\\_work.pdf](http://www.compactvoice.org.uk/sites/default/files/local_compacts_at_work.pdf)

<sup>95</sup> Mundet të gjeni shembuj plotësues të mire për bashkëpunim në marrëveshjet lokale për punë.

<sup>96</sup> „Çka e bën të suksesshëm një marrëveshje lokale“

## 4. REZULTATE KRYESORE DHE KONKLUZIONE

Vazhdimisht theksohet se sa e rëndësishme është kyçja dhe bashkëpunimi në nivel nacional dhe lokal. Marrëveshja e kantonit Sarajevë jep një pasqyrë të mirë të shkurtë të vlerave kyçe të bashkëpunimit ndër-sektorial:

*“OJQ-t mundet ta ndajnë diturinë dhe ekspertizën e vet për të dhënë një kontribut të dukshëm dhe të pavarur në procesin e sjelljes së vendimeve. Prandaj, qeveritë në gjitha nivelet, duke filluar nga ato lokalet e deri te ato rajonalet dhe nacionalet dhe institucionet ndërkombëtare, mundet ta përdorin përvojën adekuate dhe njohuritë e OJQ-ve gjatë zhvillimit dhe zbatimit të politikave të planifikuara. OJQ-t kanë besim të veçantë mes anëtarëve të vet, si edhe në gjithë shoqërinë, sepse u lejojnë anëtarëve ta shprehin brengosjen e vet duke i përfaqësuar interesat e tyre dhe u lejojnë të ndikojnë në çështje të rëndësishme, duke e realizuar kështu pjesëmarrjen e tyre për zhvillimin e politikave konkrete.”*

Në nivel evropian ekzistojnë dokumente të obligueshme dhe jo obligative të cilat kanë të bëjnë me çështjen e bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në nivel lokal. Ekzistojnë disa dokumente të BE-s dhe të Këshillit të Evropës të cilët theksojnë se vendimet duhet të sillen sa më tepër në bashkëpunim me qytetarët. Gjithashtu, nga shtetet pritet të zhvillojnë rregulla të veta të cilat do ta përmirësojnë kornizën ligjore për pjesëmarrje dhe të zhvillojnë rregulla, mekanizma dhe masa për përmirësimin e pjesëmarrjes së tillë si në nivel nacional ashtu edhe në nivel lokal.

Në nivel të BE-s, Marrëveshja e Lisbonës e siguron të drejtën e pjesëmarrjes në jetën demokratike dhe është pasqyrim i obligimit të pushteteve lokale për ti përmirësuar proceset e pjesëmarrjes. Pos kësaj Marrëveshjeje, Rezoluta për zhvillimin e dialogut e Parlamentit Evropian, në pajtim me Marrëveshjen e Lisbonës, e përforcon rëndësinë e pjesëmarrjes në të gjitha nivelet. Ajo çka është më me rëndësi është se e thekson angazhimin të cilin duhet ta bëjnë shtetet për të siguruar resurse financiare për përkrahje të kësaj pjesëmarrjeje.

Këshilli i Evropës zhvilloi disa dokumente, në lloj të kartave, protokolleve, rekomandimeve, strategji dhe kodekseve. Më e rëndësishme është Karta Evropiane për vetëqeverisje lokale e cila ishte Marrëveshja e parë ndërkombëtare e cila garanton pavarësi politika, drejtuese dhe financiare të pushteteve lokale. Edhe pos asaj që Karta në mënyrë të drejtpërdrejtë nuk e rregullon pjesëmarrjen e qytetarëve, koncepti shihet në nenin 3 i cili pranon se mundet të ekzistojnë forma të ndryshme të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të cilën qytetarët mundën ta realizojnë. Akoma më tepër, Protokollin plotësues i Kartës Evropiane përcakton se shtetet duhet ta rregullojnë të drejtën e pjesëmarrjes dhe e definojnë si të drejtë të *“kërkon të caktohet apo të ndikohet në realizimin e pushtetit dhe ingerencat e pushtetit lokal”*. Në protokollin janë cekur disa masa të cilat duhet të ndërmerren për tu siguruar kjo e drejtë.

Dokument tjetër i rëndësishëm në nivel të Këshillit të Evropës është Rekomandimi 19 i cili përfshin principe të politikës lokale demokratike dhe përcakton hapa dhe masa që ajo të arrihet. Mes tjerave, ajo rekomandon se shtetet do të duhet të zhvillojnë politika dhe ta përmirësojnë kornizën ligjore që të mundën pushtetet lokale dhe rajonale të zbatojnë dhe të shfrytëzojnë masa të ndryshme në lidhje me pjesëmarrjen lokale. Gjithashtu, inkurajohen pushtetet lokale ta përmirësojnë rregullimin lokal dhe të ndërmarrin hapa ta promovojnë pjesëmarrjen e qytetarëve.

Në nivel nacional (në bazë të informatave nga shtetet e anketuara në këtë dokument), pjesëmarrja njihet apo rregullohet me kushtetutën, ligjet, strategjitë nacionale, kodekse, dokumente të vetëqeverisjes lokale apo rregulla dhe strategji të miratuara në nivel rajonal apo lokal.

Pjesëmarrja lokale nuk kuptohet vetëm si e drejtë e dhënë me kushtetutë, por ajo rrjedh edhe nga të drejta tjera (për shembull liria e shprehjes, liria e bashkimit, e drejta për referendum). Megjithatë, Kushtetuta e Kroacisë thotë se *“qytetarët mundën në mënyrë të drejtpërdrejtë të marrin pjesë në realizimin e punëve lokale nëpërmjet takimeve, referendumit dhe formave tjera të sjelljes së vendimeve në pajtim me ligjin dhe rregullave lokale”*.

Disa aspekte për pjesëmarrje të qytetarëve janë caktuar në ligje të cilat e rregullojnë vetëqeverisjen lokale, lirinë e qasjes në informata, pastaj ligjet me të cilat rregullohet procesi ligjdhënës dhe në veçanti ligjet për procesin e sjelljes së vendimeve. Ligjet për vetëqeverisje lokale e rregullojnë pjesëmarrjen në përgjithësi dhe i lejnë nivelit lokal që vetë ta precizojë me dekrete (Hungari, Kroaci). Megjithatë, në nivel lokal nuk ekziston praktikë e dukshme që qytetet të miratojnë dekrete apo rregulla me të cilat rregullohet pjesëmarrja dhe bashkëpunimi. Një shembull i tillë është komuna e Budapestit e cila miratoi një dokument të tillë. Duke pasur parasysh se nuk ekziston praktikë e madhe që pjesëmarrja të rregullohet lokalisht ligjet nacionale munden të kyçin korniza më të hollësishme për pjesëmarrje të cilat munden që vetëqeverisjes lokale ti japin kahe dhe njëkohësisht tu lejon pushteteve lokale ti përcaktojnë specifikat në bazë të rrethanave të tyre lokale.

Strategjitë nacionale dhe kodekse luajnë rol shumë të rëndësishëm si kompas për miratimin e dokumenteve lokale. Ata shërbejnë si modele dhe inspirim për vetëqeverisjet lokale ti ndjekin tendencat nacionale dhe ti zbatojnë në nivel lokal në pajtim me nevojat e bashkësive. Deklaratat, principet dhe qëllimet e dokumenteve nacionale duket se më lehtë interpretohen dhe zbatohen nga ana e aktorëve lokal sepse ata njihen mes veti dhe komunikojnë më lehtë. Bisedat lokale dhe “marrëveshjet” zakonisht kanë më tepër aspekt praktik e më pak politik (konceptual) nga ato nacionale.<sup>97</sup> Për shembull, marrëveshjet lokale për bashkëpunim në Kroaci, Hungari dhe Angli u nënshkruan pas miratimit të strategjive nacionale nga ana e qeverive. Në Bosnje dhe Hercegovinë edhe pos asaj se miratimi i marrëveshjes nacionale i paraprinte marrëveshjeve lokale ata u zhvilluan paralelisht. Serbia tani i ndërmerr hapat e para drejt qasjes së këtillë.

Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në nivel lokal kryesisht rregullohet me dokumente jo obliguese, të cilat njihen me emrin si marrëveshje, karta, etj. Sipas kësaj ekziston nevoja për hapa të mëtutjeshme dhe angazhim i zmadhuar për tu siguruar zbatimi i tyre efektiv në praktikë. Edhe pos kësaj, duket se dokumentet e këtilla janë shumë të popullarizuara dhe mundet të vërejmë një përhapje të marrëveshjeve lokale në Kroaci, Hungari, Angli dhe në Bosnje dhe Hercegovinë. Në Angli marrëveshjet lokale janë aq të zhvilluara sa që orvatjet e tanishme janë drejtuar kah një zbatim i cili përkrahet me ushtrime dhe praktika pozitive me qëllim që të ndahen përvojat dhe të sigurohet sukcesi. Në vendet tjera, fokusi në masë të madhe është në sigurimin që këto dokumente të miratohen. Sipas kësaj, nuk mundeshim të gjejmë shumë shembuj për efektet e zbatimit të tyre. Zbatimi i këtyre marrëveshjeve si praktikë e përgjithshme në Federatën e Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungari dhe Kroaci përkrahet nëpërmjet zhvillimit të planeve vjetore për aksion dhe formimin e organeve (këshillave) si përkrahje për zbatimin.

Me rëndësi është të ceket se bashkëpunimi dhe pjesëmarrja nuk përmirësohet vetëm me shoqata dhe fondacione por gjithashtu është e hapur për qytetarë si dhe për grupe të pargjistruara dhe joformale. Në Kroaci, Kodeksi për praktikumin e konsultimeve ka të bëjë me opinionin e interesuar, i cili përfshin qytetarë, OJQ të regjistruara dhe jo të regjistruara, institucione private, sindikatë, etj.

Gjetëm vetëm disa shembuj ku konsultimi dhe pjesëmarrja në proceset e sjelljes së vendimeve është lokalisht e rregulluar. Njëri nga ato është Dekreti i Komunës së Budapestës, kurse tjetri është marrëveshjet lokale në Angli (p.sh Marrëveshja lokale në Bakingesmsbir e cila përmban shumë procedurë të hollësishme për këtë). Në pajtim me rekomandimet evropiane, qytetarët do të duhet të kenë mundësi të kyçen në proceset e sjelljes së vendimeve, kurse sa më herët do të duhet të kyçen edhe në fazat e ndryshme të procesit. E një rëndësie të madhe është të kihet parasysh se konsultimi është proces dykahësor ku të dy palët kanë përgjegjësi të vete personale dhe munden të kenë dobi nga e njëjta.

Aspekti i financimit të bashkëpunimit mund të vlerësohet nëpërmjet prizmës së asaj sa pare ka në dispozicion për OJQ- lokale dhe për përkrahjen e bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes dhe si ato shpërndahen. Kroacia theksohet si vend i cili jep përkrahje për zhvillim të OJQ-ve në nivel rajonal dhe lokal, kurse përkrahja e këtillë analizohet çdo

<sup>97</sup> Nilda Bullain dhe Radost Toftisova (2004): *Analizë komparative e politikave evropiane dhe praktika të bashkëpunimit të OJQ- qeveri*. ECNL, Budapest.

vit nga ana e Zyrës për bashkëpunim me shoqatat në bazë të rezultateve hyrëse të pushteteve rajonale dhe lokale. Në vende tjera, shumica e mjeteve dallon nga qyteti në qytet, por marrë në përgjithësi do të duhet të zmadhohet dhe ti përgjigjet nivelit real të kyçjes së OJQ-ve në zbatimin e detyrave publike lokale.

Nga aspekti i asaj si shpërndahen ato ndahen nëpërmjet tenderëve kryesisht në Hungari, Kroaci dhe Angli.

### **Mekanizma dhe modele që përdoren për ta përmirësuar pjesëmarrjen**

Pos modeleve të kyçura në kushtetutat dhe aktet themelore ligjore (referendum, qytetarë dhe peticione), vendet e analizuara në këtë dokument kanë miratuar edhe mekanizma dhe modele tjera me qëllim që ta lehtësojnë bashkëpunimin dhe ti kyçin OJQ-t në proceset lokale. Këto modele mundet të grupohen në disa kategori.

**Rregulla:** edhe pos asaj që zakonisht nuk janë praktikë, rregullat janë dokumente të rëndësishme sepse ata janë të obligueshme dhe me këtë vetëqeverisjet lokale sigurojnë qasje deri te informatat dhe i kyçin qytetarët në proceset e sjelljes së vendimeve.

**Politika lokale (marrëveshje):** ky është modeli më i zakonshëm që ekziston në shtete. Qëllimi i tyre kryesor është të merret parasysh gjendja e tanishme e bashkëpunimit, të caktohen qëllimet e veçanta dhe të ndahen detyra dhe rekomandime me qëllim që të njëjtat të plotësohen. Dokumentet lokale zakonisht kanë përmbajtje të ngjashme me atë të përfshirë në dokumentet nacionale, por ata synojnë të jenë më specifike dhe të orientuara drejt praktikës. Politikat lokale duhet ta vlerësohen minimum një herë në vit. Disa politika lokale propozojnë miratimin e planeve konkrete të aksionit si përkrahje të procesit të zbatimit. Tjerët gjithashtu formojnë organ të veçantë të përbërë nga përfaqësues edhe të vetëqeverisjes lokale dhe OJQ-ve për të siguruar mbikëqyrjen dhe zbatimin më të mirë.

**Zyra/qendra lokale:** disa vetëqeverisje lokale formojnë njësi apo zyra. Rolet e tyre janë të ndryshme. Disa sigurojnë hapësira për zyrë dhe pajisje si përkrahje të punës së OJQ-ve (shembull Serbia). Të tjerë kryejnë detyra për ta zgjeruar bashkëpunimin, për shembull mbajtjen e internet faqeve, punë me baza të dhënash, dërgimin e buletineve, koordinim dhe përkrahje të punës së organeve ndër-sektoriale, informim për mundësitë e financimit dhe shpërndarjen e mjeteve të OJQ-ve, vlerësimin e sektorit qytetar dhe rregulla adekuate për përmirësimin e mjedisit për punën e tyre.

**Persona përgjegjës për bashkëpunim** mundet të ekzistojnë në ato qytete ku nuk ka mjete të mjaftueshme për tu formuar zyrë e veçantë (p.sh Hungari). Ata zakonisht kanë role të ngjashme si zyrat e veçanta. Ata mundet të jenë pjesë e zyrës së kryetarëve të komunave apo të jenë në zyrat e departamenteve për marrëdhënie me opinionin.

**Organe ndër-sektoriale** (këshill, komisione) formohen për qëllime të ndryshme. Ata mundet të formohen për të punuar dhe të japin këshilla për nevoja konkrete të bashkësisë, siç është zhvillimi i qytetit, sportit, persona me pengesa në zhvillim (p.sh Serbi). Ata mundet të japin mendime për dokumente të cilat i japin organet e vetëqeverisjes lokale, mundet të japin propozime për çështje konkrete, përcaktimin e prioritetëve për financim të bashkësisë lokale dhe të OJQ-ve dhe të përcaktojnë drejtime për zhvillim të shoqërisë civile. Në disa shtete ata formohen me qëllim që ta përkrahin zbatimin e dokumenteve politike (p.sh. Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë). Për tu siguruar përfshirje më e gjerë të bashkëpunimit, mundet të formohen grupe punuese (rasti me Kardeldale dhe Hertforshir në Angli) të cilët sigurojnë kyçje në nivel nën-sektorial në procesin e sjelljes së vendimeve (të cilët i kyçin vetëqeverisjes lokale, OJQ-ve, odave ekonomike, etj.).

**Organe të udhëhequra nga OJQ-t.** Organet e udhëhequra dhe të përbëra vetëm nga OJQ janë iniciativa të nivelit më të ulët formimi i të cilëve varet nga kyçja aktive e OJQ-ve dhe angazhimi për tu formuar organe të tilla. Ata janë zyrtarisht partner i pranuar nga vetëqeverisja lokale. Ky model ekziston në Budapest në formë të punëtorive qytetare dhe në Szentes si këshill qytetar. Nevojitet numër minimal i anëtarëve që organi të mundet të funksionon në mënyrë efikase.

**Fondacione lokale.** Ky model ekziston në Kroaci. Fondacioni në rajonin Istra është njëri nga fondacionet i cili punon në nivel rajonal për të siguruar financim dhe përkrahje të OJQ-ve. Ai është fondacion publik-privat i cili i cili pos burimeve tjera merr pare edhe nga Fondacioni Nacional dhe buxhetet e vetëqeverisjeve lokale. Ai ka funksion financiar, arsimor dhe informativ.

**Bazë e të dhënave.** Disa qytete kanë formuar bazë të dhënave për OJQ lokale të cilat përdoren për mbledhjen e informatave për OJQ-t aktive dhe të interesuara në bashkësi. Këto baza të dhënave përdoren për tu lehtësuar proceset e financimit, komunikimit dhe bashkëpunimit (p.sh. për dërgimin e buletineve, lehtësimin e lidhjeve mes palëve të interesuara të cilët duan të jenë partnerë në çështje konkrete).

**Përdorimi i internet – teknologjisë.** Interneti përdoret në masë të madhe duke e pasur parasysh mekanizmin më të lirë i cili siguron qarkullim më të lehtë të informatave, mundet të depërton deri te grupi më i gjerë në bashkësi dhe mundet të ndihmon të rritet transparenca e punës në vetëqeverisjen lokale. Detyrë e rëndësishme e pushtetit lokal është të sigurohet ekzistimi i bazës teknike ashtu që personat me pozitë jo të volitshme sociale gjithashtu të kenë qasje në internet dhe të kenë dobi nga përdorimi i tij. Për këtë qëllim, në formimin e [teleshtëpive](#) shohim si në pranimin e përgjegjësive ndër-sektoriale dhe partneritet për sigurimin e qasjes deri te informatat për të gjithë. Ata janë një lloj e “infotekës” e cila i lidh bashkësitë e izoluar rurale duke e dërguar IT pajisjen deri te bashkësitë e vogla dhe në këtë mënyrë sigurojnë mundësi të shumta për angazhimin dhe zhvillimin e njerëzve të cilët përndryshe janë të izoluar në jetën e tyre të përditshme. Në Hungari dhe Angli ekzistojnë shembuj të [internet faqeve të veçanta](#) të krijuara me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave. Ata i shpallin informatat në lidhje me aktivitetet e pushtetit lokal, informatat dhe aktivitetet e OJQ-ve lokale dhe listën e OJQ-ve në bashkësi. Në Budapest internet faqja përdoret për mbledhjen e mendimeve për propozim ligje. [Listat elektronike](#) gjithashtu përdoren për të shpërndarë informata deri te të interesuarit paraprakisht të regjistruar dhe deri te OJQ-t. Në Angli përdoret [internet – shpërndarja](#) si metodë interneti për kyçjen e qytetarëve të cilët nuk janë në gjendje personalisht të marrin pjesë në takim. Ata mundësojnë drejtpërdrejtë të merret pjesë në takime të këshillave dhe forumeve tjera dhe të dërgojnë komente dhe pyetje nëpërmjet internetit.

## 5. REKOMANDIME APO ÇKA TË MERRET PARASYSH KUR BËHET FJALË PËR MODEL PËR BASHKËPUNIM DHE PJESËMARRJE

Shqyrtimi i shkurtë për pesë vendet në këtë dokument tregon se edhe pos pengesave të gjithë ata synojnë drejt miratimit të metodave të ngjashme për bashkëpunim. Zhvillimi dhe zbatimi i modeleve dhe zbatimi i tyre i suksesshëm varet nga disa faktorë. Faktorët e këtillë përfshijnë ekzistimin e bashkëpunimi, motivime dhe dëshirë për bashkëpunim, angazhim të palëve në proces, kuptimin e vlerave dhe dobive, ndarjen e resurseve dhe ruajtjen e fokusit për të siguruar miratimin e modeleve. Disa modele janë përdorur për shkak të ekzistimit të resurseve (për shembull Fondacioni i rajonit të Istrës). Të tjerë kanë shfrytëzuar për shkak të kulturës së vjetër dhe traditës së gjatë të bashkëpunimit (për shembull marrëveshjet lokale në Angli). Megjithatë, kjo nuk donë të thotë se duhet të ekzistojnë të gjithë faktorët për tu miratuar një model. Para së gjithash, ky është një proces dhe nëpërmjet procesit ndryshohen dhe formulohen kushtet për zhvillimin dhe zbatimin e tij. Me rëndësi është të ngelet kooperativë dhe i përkushtuar dhe të kihet besim në modelin potencial. Vijnë lista e pyetjeve kyçe të cilat duhet të merren parasysh kur zhvillohet një model për bashkëpunim dhe pjesëmarrje.

### Cili është qëllimi?

Siç tregon ky dokument, ekzistojnë disa modele të cilat munden të përdoren për përmirësimi e pjesëmarrjes dhe bashkëpunimit në nivel lokal, por ekzistojnë dallime nga aspekti i roleve të cilat ai mundet ti ketë dhe në rezultatet e pritura. Sipas kësaj, rekomandojmë aktorë lokal (pushtete, OJQ, qytetarë dhe grupe) qartë të definojnë cilat aspekte të bashkëpunimit dëshirojnë ti përmirësojnë, cili është qëllimi gjithëpërfshirës dhe cilat janë qëllimet dhe çka dëshirohet të arrihet. Edhe pos kësaj se modelet lehtë mundet të kopjohen ata jo gjithnjë janë të zbatueshme në gjitha rrethanat.

Po prandaj, kur shqyrtohet një model nga ndonjë shtet tjetër apo qytet ose komunë, duhet të merren parasysh rrethanat, faktorët të cilët munden të stimulojnë apo pengojnë zbatimin, masat të cilat janë të domosdoshme ai të zbatohet dhe të ruhet. Në bazë të kësaj, modeli mundet të adaptohet për tu arritur rezultatet e kërkua.

### Cili është grupi qëllimor?

Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi nuk duhet të jenë të rezervuara vetëm për OJQ-t. Në princip, ajo është e dedikuar qytetarëve, kurse OJQ-t janë mjet nëpërmjet të cilave ata munden të marrin pjesë në proceset lokale. Duke pasur



parasysh se bashkësia lokale është më lehtë e lidhur me qytetarët, ndonjëherë ata mundën të kyçen pa ndërmjetësues. Madje edhe kur flasim për OJQ-t, shumë është me rëndësi të zgjerohet përfshirja e atyre të cilët kanë të drejtë të marrin pjesë në proceset lokale. Me qëllim të informimit më të mirë për nevojat e qytetarëve dhe menaxhim më efektiv, nuk duhet të merren parasysh vetëm shoqatat dhe fondacionet e regjistruara por gjithashtu edhe grupet joformale dhe OJQ me forma të ndryshme ligjore (shoqata jofitimprurëse me përgjegjësi të kufizuara, etj.)

## Si të kyçet grupi?

Është qartë se ky model duhet të zhvillohet me pjesëmarrjen e gjitha grupeve. Opinioni duhet të kyçet në zhvillimi e modelit që në fazat e hershme. OJQ-t dhe palët tjera gjithashtu mundën të sjellin resurset e veta (njerëzore dhe financiare) si plotësim të iniciativave dhe orvatjeve të pushtetit lokal dhe të përkrah implementimi.

Ajo çka është e rëndësishme, e në veçanti e dukshme në nivel lokal, është se procesi jo vetëm që kontribuon për krijimin e modelit të mirë, por gjithashtu edhe për vendosjen e partneriteteve më të forta dhe lidhjeve mes atyre që janë kyçur. Planet e parapara për modelet plotësisht zhvillohen dhe formohen me zhvillimin e procesit, idetë shkëmbehen dhe rritet kreativiteti i grupi. Si pjesë e kësaj, ndërtohet besimi dhe pronësia dhe forcohet ndjenja e përkushtimit të kontribuohet në zbatim.

## Si duhet të rregullohet?

Bashkëpunimi e në veçanti pjesëmarrja, mundet të jenë të dobishme kur janë të parapara me Kushtetutë, por ajo çka është më e rëndësishme është se duhet të ketë bazë më të fortë në ligjet për vetëqeverisje lokale dhe çështje tjera të cilat ndikojnë mbi pjesëmarrjen (p.sh. qasje në informata, procesi ligjdhënës, etj.). Edhe pos asaj se në kornizë dhe në kërkesat themelore të obligueshme për të gjitha pushtetet duhet të kyçen në legjislacionin nacional, pushtet lokale duhet të kenë autonomi për të mundur në dokumentet lokale plotësisht ti përpunojnë hollësitë e bashkëpunimit.

Në vendet ku bashkëpunimi dhe pjesëmarrja nuk janë të zhvilluara në nivel lokal, me siguri më mirë është nëse ka obligim, dispozitat e tilla të kyçen në dokumentet e obligueshme (dekretet i pushtetit lokal). Kjo mundet të siguron përputhshmëri më të mirë dhe zbatim më të suksesshëm.

Paralelisht me këtë, në dokumentet lokale politike (marrëveshje, kontrata) mundet të kyçen aspekte më të gjera për bashkëpunim të cilët mundet të ko-ekzistojnë me dekretet dhe ti plotësojnë.

Një dokument i qartë dhe i kuptueshëm mundet ta jep kornizën për bashkëpunim dhe tu ndihmojë njerëzve të cilët punojnë në pushtet të kuptojnë si shoqëria civile mundet ti përkrah shërbimet e dhëna.

Me qëllim që të sigurohet zbatim më i mirë, duhet të përgatiten dhe distribuohen publikime që kanë të bëjnë me rolin e shoqërisë civile dhe të potencohet teoria me shembuj konkret të cilët mundet të ndiqen nga ana e atyre zbatuesve dhe nga vetëqeverisjet tjera lokale të cilat kanë miratuar modele të ngjashme.

## Si të sigurohet kyçje më e gjerë në model?

Interneti luan rol gjithnjë e më të rëndësishëm në shkëmbimin e informatave dhe në konsultimet me OJQ-t dhe është mënyra më e lehtë dhe më e lirë për të arritur deri te njerëzit. Një lidhje e veçantë nga internet faqja deri te vetëqeverisja lokale mundet të jetë vend i mirë për komunikim me opinionin. Nëpërmjet internetit mundet të incizohen informata të shumta të dobishme të cilat ndikojnë në numër të madh të njerëzve dhe OJQ-ve (siç janë lajmet, baza e të dhënave për OJQ lokale, rendi i ditës dhe proces verbalet nga takimet e këshillit lokal, mundësitë për financim, etj.).

Aktivitetet e vetëqeverisjes lokale mundet të jenë akoma më të hapura nëse përdoret internet-shpërndarja, siç është në Haringej (Angli). Ekzistojnë vegla mjaftë të lira dhe efektive nëse sigurohet baza teknike.

Pushteti lokal do të mundet të bashkëpunon me OJQ-t dhe me ndërmarrjet lokale për të siguruar qasshmëri deri në internet për personat që janë në pozitë jo të volitshme në tërë vendin. Në raste kur popullata nuk është në gjendje të shfrytëzon internet, mundet të botohen broshura dhe qytetarëve tu shpërndahen informatat të cilat gjithashtu janë të qasshme edhe në internet.

Edhe pos krejt kësaj, internet faqja nuk do ti lej anësh marrëdhëniet e drejtpërdrejta ti cilat realizohen nëpërmjet buletineve elektronik, postës, ditëve për qytetare, punëtori qytetare, biseda publike, takime qytetare. Me rëndësi

është të sigurohet kapacitet i mjaftueshëm për këtë qëllim në kuadër të vetëqeverisjes lokale ( në formë të zyrës për qytetarë apo person nga personeli përgjegjës për bashkëpunim mes OJQ-ve dhe pushtetit lokal) dhe edukimi i nëpunësve tjerë lokal (për shembull sigurimi i fletushkave si pjesë e aktiviteteve për rekrutim të anëtarëve të ri nga personeli).

### Si duhet të mbikëqyret dhe rishikohet?

Funksionimi i modelit duhet periodikisht të ndiqet dhe të rishikohet. Për shembull, rregullisht duhet të rishikohet zbatimi i planeve lokale për aksion me qëllim që të caktohet çka është bërë dhe cilat hapa duhet të ndërmerren në të ardhmen. Planet e aksionit mundet të ndihmojnë të ndiqet implementimi i hapave të drejtpërdrejta dhe prioritetet afatshkurta. Raportet vjetore për implementim të një dokumenti politik apo të një pune të organit ndërkombëtar apo zyrës së qeverisë lokale mundet të shërbejnë si informatë e mirë kthyesë për të arritur besim më të madh në partneritet, për shkak se ata munden më qartë ta tregojnë dobinë dhe rezultatet e arritura.

### Mjete financiare për modelin

Mjetet financiare në diskutim për zhvillimin dhe zbatimin e modelit kanë të bëjnë me suksesin e tij. Duhet të merren parasysh nevojat e përgjithshme në vijim: sa kohë do të duhet ai të zhvillohet, cilat metoda të konsultimit do të përdoren, sa duhet që të vendoset dhe çka nevojitet për tu siguruar zbatimi i tij efikas. Sipas kësaj, shumica e burimeve financiare duhet të sigurohet para se zyrtarisht të fillojë procesi.

Pyetje për shkak të falënderimit	Panele të qytetarëve	Gjykatës të qytetarëve	Dialog / arritja e konsensusit
Konferencë për konsensus	Mapim këshillëdhënës	Anketë këshillëdhënëse	Takime këshillëdhënëse
Hulumtim i ardhshëm	Procese interaktive elektronike	Ngjarje të hapura	Vlerësim i pjesëmarrjes
Planifikim strategjik për pjesëmarrje	Planifikim real	Panele të shfrytëzuesve	Iniciativa për dhënien e pushtetit të rinjve

*Burim: Pjesëmarrje: tendenca, fakte dhe numra, Almanak. NCVO, mars 2011.*

[www.mcms.org.mk](http://www.mcms.org.mk)

